FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 42	2001	Gusht

P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM nr.465, datë 19.7.2001	Për metodologjinë e rregullimit të tarifave të operatorit publik të telekomunikacioneve të Albtelecom sh.a-së.……..…	1299
Vendim i KM nr. 474, datë 19.7.2001	Për rritjen e çmimeve të shitjes me pakicë të teksteve shkollore të arsimit parauniversitar……	1302
Vendim i KM nr. 476, datë 19.7.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001; nr.158, datë 22.3.2001; nr.167, datë 30.3.2001; nr.174, datë 30.3.2001; nr.197, datë 6.4.2001; nr.385, datë 31.5.2001 dhe nr.424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave ……...	1303
Vendim i KM nr. 477, datë 19.7.2001	Për lejimin e importeve të nënprodukteve të naftës për përdorim vetjak nga shoqëritë e ndërtimit që punojnë në projekte me financime të huaja ("PHARE", "CBS & TRANSPORT", "BERZH", "BANKA BOTËRORE" etj.), të cilat janë përjashtuar nga taksat doganore dhe akcizat ……	1304

Vendim i KM nr. 478, datë 19.7.2001	Për sigurimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" në rrjetet informatike, mjetet dhe pajisjet e transmetimit……	
Vendim i KM nr. 481, datë 19.7.2001	Për pranimet në shkollat e larta për vitin akademik 2001-2002 në sistemin me shkëputje nga puna, si edhe për tarifën e shkollimit, po për vitin akademik 2001- 2002 ……	1307
Udhëzim i KM nr.6, datë 19.7.2001	Për një ndryshim në udhëzimin nr.4, datë 22.8.1994 të Këshillit të Ministrave "Për vlerësimin e apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore", ndryshuar me udhëzimin nr.1, datë 12.1.2001 të Këshillit të Ministrave ……..	1313
Vendim i GJK nr. 59, datë 4.7.2001	Me objekt pavlefshmërinë e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për zonën zgjedhore nr.20 Dibër, të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.970, datë 29.6.2001……	1313
Vendim i GJK nr.80, datë 12.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.007, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.40 dhe të vendimit nr.16, datë 27.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.40 dhe urdhërimin e raundit të dytë të zgjedhjeve për zhvillimin e balotazhit në zonën zgjedhore nr.40……..	1315
Vendim i GJK nr.81, datë 7.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.096, datë 3.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.……	1317
Vendim i GJK nr.82, datë 18.7.2001	Me objekt shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr.171, datë 13.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.……	1318
Vendim i GJK nr.83, datë 20.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.178, datë 17.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve……	1320
Vendim i GJK nr.84, datë 12.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.988, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përsëritjen e zgjedhjeve në 5 qendra votimi……	1321
Vendim i GJK nr.85, datë 10.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.946, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve……	1323
Vendim i GJK nr.86, datë 18.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.172, datë 13.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve……	1325
Vendim i GJK nr.88, datë 10.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.010, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve……	1328
Vendim i GJK nr.89, datë 14.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.944, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ……	1329
Vendim i GJK nr.90, datë 25.7.2001	Me objekt shpalljen si antikushtetuese të vendimeve nr.1319, datë 12.3.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.1515, datë 11.6.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.1303, datë 7.11.1997 të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.B-15, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë……	1331

Vendim i GJK nr.91, datë 12.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.006, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve……	1334
Vendim i GJK nr.92, datë 20.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.170, datë 13.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve……..	1336
Vendim i GJK nr.94, datë 26.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.183, datë 19.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.82 dhe të vendimit nr.13, datë 15.7.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore ose konstatimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendrat e votimit nr.16, 17, 30, 32, 33, 34, 35 dhe 36 të zonës zgjedhore nr.82……	1339
Vendim i GJK nr.95, datë 27.7.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.4, datë 4.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; nr.32, datë 14.3.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.344, datë 5.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë……	1341
Vendim i GJK nr.96, datë 27.7.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.120, datë 3.3.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë……..	1343
Vendim i GJK nr.97, datë 27.7.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.3186, datë 24.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Durrës; nr.1631, datë 22.3.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.1422,datë 8.10.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.N-18, datë 18.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë……..……	1345
Vendim i GJK nr.99, datë 31.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.196, datë 24.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve……	1348
Vendim i GJK nr.106.datë 1.8.2001	Me objekt shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.1175, datë 20.10.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.1342, datë 2.11.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë……	1349

V E N D I M
Nr.465, datë 19.7.2001

PËR METODOLOGJINË E RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË OPERATORIT PUBLIK TË TELEKOMUNIKACIONEVE TË ALBTELECOM, SH.A.-SË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 59 dhe 62 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Metodologjia për rregullimin e tarifave të shërbimeve telefonike të qëndrueshme dhe të shërbimit të linjave me qira të ofruara nga operatori publik i telekomunikacioneve të Albetelecom sh.a.-së, cilësuar nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve si organizëm me fuqi të ndjeshme në treg, të jetë mekanizmi i çmimit tavan sipas formulës që më poshtë vijon:

Ti= Ti-1 (1+I-X+Z),

Ku:

Ti – tarifa për një minutë shërbimi telefonik ose tarifë shërbimi për vitin "i";

Ti-1 – tarifa për një minutë shërbimi telefonik ose tarifë shërbimi për vitin paraardhës;

I – treguesi i inflacionit të vitit paraardhës në % i raportuar nga Instituti i Statistikës;

X – faktori i përmirësimit të frytshmërisë së operatorit në %;

Z – faktori rregullues i tarifës në %

Vlerat X dhe Z jepen në lidhjen nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shportat e shërbimeve për çdo vit dhe rregullimi mesatar tavan i tyre të jenë ato të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Vlera e shportës së shërbimeve të çdo viti të llogaritet në bazë të trafikut në minuta, të kryer në vitin paraardhës dhe të mesatares së tarifave të këtij viti dhe atyre të vitit llogaritës, ponderuar me trafikun në minuta, të realizuar në vitin paraardhës. Tarifat përkatëse të zërave të shërbimeve brenda çdo shporte nuk duhet të jenë më të larta se ato të përcaktuara sipas formulës së pikës 1 të këtij vendimi.

3. Rregullimi i tarifave në përputhje me këtë vendim të bëhet për aq kohë sa Albtelecom sh.a.-ja të cilësohet organizëm me fuqi të ndjeshme në treg. Tarifat e reja të hyjnë në fuqi në fillim të çdo viti kalendarik. Për vitin 2001 ndryshimi i tarifave të bëhet në datën 1 gusht.

4. Albtelecom sh.a.- ja të përcaktojë koston e plotë të çdo zëri shërbimi. Në përputhje me këto kosto dhe për rregullimin e tarifave të Albtelecom sh.a.- së në vazhdimësi, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, jo më vonë se 5 vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të propozojë amendimet përkatëse në lidhjet nr.1 dhe nr.2, të këtij vendimi.

5. Në strukturën e re tarifore, Albtelecom sh.a.-ja:

a) Të zbatojë:

i) për përdoruesit e kategorisë "Familjarë", shkallëzimin e impulseve me çmim pa TVSH, si më poshtë:

0 – 150 impulse 1 lekë

mbi 150 impulse 4 lekë

ii) për përdoruesit e kategorisë "Të tjerë" çmimin pa TVSH

për çdo impuls 7 lekë.

b) të zbatojë ndryshimin e tarifave sipas pikës 1 të këtij vendimi, nëpërmjet ndryshimit të ritmit të impulseve të tarifimit.

c) të zbatojë breza orare për të gjitha llojet e bisedave.

6. Albtelecom sh.a., të zbatojë zbritje në pagesat e përdoruesve në masën 2.5 për qind kur shuma në faturën mujore të jetë mbi 1 500 lekë, për përdoruesit e kategorisë "Familjarë", dhe mbi 15 000 lekë për përdoruesit e kategorisë "Të tjerë".

7. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Lidhja 1. VLERAT E X DHE Z NË FORMULËN E ÇMIMIT TAVAN
Për të gjitha shërbimet x = 2.5%

A. Shërbimet telefonike të qëndrueshme	Z (%) për tarifat e shportës"Familjarë"	Z (%) për tarifat e shportës "Të tjerë"
Tarifë e instalimit	3.4	-13.1
Pajtim mujor	27.1	11.0
Tarifa e pikut (1 minutë)		
Bisedë lokale brenda zonës urbane dhe komunës	44.0	34.7
Bisedë kombëtare:		
në distancë deri 25 km	0.4	- 2.6
në distancë 25-50 km	- 9.1	- 11.9
në distancë 50-100 km	- 10.9	- 15.6
në distancë mbi 100 km	- 17.7	- 21.3
Tarifa e zakonshme (1 minutë)		
Bisedë lokale brenda zonës urbane dhe komunës	19.0	33.1
Bisedë kombëtare:		
në distancë deri 25 km	0.3	- 1.2
në distancë 25-50 km	- 9.1	- 10.4
në distancë 50-100 km	-12.2	- 14.8
në distancë mbi 100 km	-18.1	- 19.6
Tarifa e reduktuar (1 minutë)		
Bisedë lokale brenda zonës urbane dhe komunës	10.3	8.8
Bisedë kombëtare:		
në distancë deri 25 km	- 3.3	- 2.0
në distancë 25-50 km	- 12.4	- 11.3
në distancë 50-100 km	- 16.5	- 15.4
në distancë mbi 100 km	- 22.4	- 20.2
Tarifa ndërkombëtare piku (1 minutë)		
Bisedë me vendet fqinje	2.2	2.2
Bisedë me Europën, zona 1	1.5	1.5
Bisedë me Europën, zona 2	2.2	2.2
Bisedë me vendet e tjera	0.8	0.8
Tarifa ndërkombëtare e reduktuar (1 minutë)		
Bisedë me vendet fqinje	- 2.4	- 2.4
Bisedë me Europën, zona 1	- 2.5	- 2.5
Bisedë me Europën, zona 2	- 2.1	- 2.1
Bisedë me vendet e tjera	- 1.9	- 1.9
B. Shërbime të linjave me qera	Z (%) për tarifat e shportës Linja me qera	
1. Linja me qera kombëtare		
Tarifa e instalimit për linja 64 kbit/s	126.4	
2 Mbit/s	403.0	
Pajtimi mujor për linja 64 kbit/s		
dhe distanca: deri 25 km	- 58	
25 – 50 km	- 69.2	
50 – 100 km	- 69.0	
mbi 100 km	- 65.7	
Pajtimi mujor për linja 2 Mbit/s		
dhe distanca: deri 25 km	- 66.4	
25 – 50 km	- 80.2	
50 – 100 km	- 73.8	
mbi 100 km	- 76.5	
2. Linja me qera ndërkombëtare		
Tarifa e instalimit për linja 64 kbit/s	- 52.7	
512 kbit/s	- 54.3	
2 Mbit/s	- 46.8	
Pajtimi mujor për		
Vendet fqinje		
Për linja 64 kbit/s	- 47.2	
512 kbit/s	- 42.8	
2 Mbit/s	- 31.9	
Europën, zona 1		

64 kbit/s	- 52.5
512 kbit/s	- 48.2
2 Mbit/s	- 38.5
Europën, zona 2	
64 kbit/s	- 43.3
512 kbit/s	- 37.8
2 Mbit/s	- 29.1
Vendet e tjera	
64 kbit/s	- 47.0
512 kbit/s	- 41.8
2 Mbit/s	- 33.7

Lidhja 2. Shportat e shërbimeve dhe rregullimi tavan

1. Shportat dhe kategoritë e shërbimeve për çdo shportë janë:

a) shporta e shërbimeve telefonike të qëndrueshme për kategorinë "Familjarë":

pajtim, instalim, bisedë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;

b) shporta e shërbimeve telefonike të qëndrueshme për kategorinë "Të tjerë": pajtim, instalim, bisedë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;

c) shporta e shërbimeve për Linja me Qira: pajtim dhe instalim linjash kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Rregullimi mesatar vjetor tavan i vlerave të shportave të shërbimeve për periudhën e rregullimit 2001-2005 jepet në tabelën e mëposhtme:

Shporta	Rregullimi mesatar vjetore tavan i shportës
Familjarë	- 1.6%
Të tjerë	- 0.4%
Linja me qira	- 13%

V E N D I M
Nr. 474, datë 19.7.2001

PËR RRITJEN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË TEKSTEVE SHKOLLORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992, "Për çmimet dhe tarifat", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të teksteve të arsimit parauniversitar të rriten mesatarisht 15 për qind për tekstet e arsimit tetëvjeçar dhe 25 për qind për tekstet e arsimit të mesëm, kundrejt çmimeve të tyre, me pakicë në fuqi, të miratuar me vendimin nr. 438, datë 15.9.1999 të Këshillit të Ministrave "Për rritjen e çmimeve të shitjes me pakicë, të teksteve të arsimit shkollor, parauniversitar".

2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të llogarisë titull për titull, çmimet e reja të teksteve shkollore dhe t'i shpallë ato për zbatim menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi. Këto çmime të zbatohen për të gjitha tekstet shkollore të arsimit parauniversitar, që janë në gjendje të prodhuara apo në qarkullim, si dhe për ato që do vazhdojnë të shtypen, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3.Diferencat ndërmjet çmimeve të reja dhe atyre të mëparshme, për sasitë e shtypura, gjendje apo në qarkullim, pranë subjekteve përkatëse të shitjes me pakicë, me efekt financiar prej rreth 7 000 000 (shtatë milionë) lekësh, të grumbullohen dhe të përdoren nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për shtypjen e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar gjatë vitit 2001.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të ndjekin dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e rregullt të inventarizimeve, për sistemimin e diferencave të çmimeve të teksteve, gjendje të prodhuara dhe

derdhjen e tyre nga subjekti, që i zotëron për llogari të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, gradualisht me shitjen me çmimet e reja, deri në fund të muajit nëntor 2001.

5. Diferencat ndërmjet shpenzimeve të prodhimit e të shpërndarjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar dhe të çmimeve përkatëse të shitjes me pakicë të tyre, të caktuara sipas këtij vendimi, të vazhdojnë të subvencionohen nga Buxheti i Shtetit, sipas shumës vjetore përkatëse, të miratuar në Buxhetin e Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 476, datë 19.7.2001

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE", NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.39, DATË 26.1.2001. NR.158, DATË 22.3.2001. NR.167, DATË 30.3.2001, NR.174, DATË 30.3.2001, NR.197, DATË 6.4.2001, NR.385, DATË 31.5.2001 DHE NR.424, DATË 11.6.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 2 dhe 6 të ligjit 8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për përcaktimin e pagave të punës" dhe të nenit 17 të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës" të ndryshuar me ligjin nr.8335 datë 23.4.1998, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001, nr.158, datë 22.3.2001, nr.167, datë 30.3.2001, nr.174, datë 30.3.2001, nr.197, datë 6.4.2001. nr.385, datë 31.5.2001 dhe nr.424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në lidhjen 1, "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", në klasifikimin B3 shtohet funksioni "Kryeinspektor i policisë së bashkisë së Tiranës", dhe në klasifikimin B5 shtohet funksioni "Inspektor i policisë së bashkisë së Tiranës".

2. Në lidhjen II-17 , "Niveli i pagës për punonjësit e bashkisë së Tiranës" pas emërtimit "Për njësitë bashkiake të Tiranës", shtohet emërtimi "Për policinë e bashkisë së Tiranës", me këtë përmbajtje:

Kryeinspektor B3
InspektorB5
PolicëKlasa XII, Lidhjes II

3. Në lidhjen II-A, "Shtesat mbi pagë për funksione drejtuese", kreu II, "Shtesa të tjera", pas pikës 25 shtohet pika 26, me këtë përmbajtje:

"26. Punonjësit e policisë së bashkisë së Tiranës përfitojnë shtesë page për vështirësi si më poshtë:

Kryeinspektor 10%
Inspektor 20%
Polic80%

4. Në strukturën e aparatit të bashkisë së Tiranës shtohen 30 punonjës, dhe konkretisht:

Kryeinspektor 1
Inspektorë 5
Policë24

Gjithsej30

5. Efektet financiare për pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative, për veshmbathje dhe pajisjen e punonjësve të pikës 2 të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2001, miratuar për bashkinë e Tiranës.

6. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 477, datë 19.7.2001

PËR LEJIMIN E IMPORTEVE TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS PËR PËRDORIM VETJAK NGA SHOQËRITË E NDËRTIMIT, QË PUNOJNË NË PROJEKTE ME FINANCIME TË HUAJA ("PHARE", CBS & TRANSPORT", "BERZH", "BANKA BOTËRORE" ETJ.) TË CILAT JANË PËRJASHTUAR NGA TAKSAT DOGANORE DHE AKCIZAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me propozimin e ministrit të Transportit, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëritë kontraktore që punojnë për zbatimin e projekteve, që financohen nga donatorë apo financues të ndryshëm të huaj, me të cilët shteti ka nënshkruar marrëveshje të ratifikuara në Kuvend, të cilat parashikojnë shprehimisht, përjashtimin e importeve nga taksat ose çdo detyrim tjetër doganor, kanë të drejtë të importojnë nënprodukte nafte për përdorim vetjak, brenda periudhës së kontratës, pa paguar detyrimet për taksat doganore dhe akcizat.

2. Ministria e Transportit, në mbështetje të projekteve dhe preventivave të miratuara për investimet që përfitojnë përjashtim nga taksat doganore të importit, të paraqesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sasitë e karburantit që konsumon secila shoqëri në vit, të ndarë në tremujorë.

3. Për çdo rast importi të karburantit, shoqëritë e mësipërme t'i paraqesin Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave kërkesën me shkrim për përjashtimin nga detyrimet doganore të importit. Kërkesa të shoqërohet me dokumentacionin argumentues të tërheqjes së sasisë së karburantit, të autorizuar më parë për përjashtimi nga taksat doganore, si dhe të një deklarate me shkrim, që kjo sasi karburanti është përdorur sipas destinacionit të miratuar.

4. Ngarkohen Ministria e Transportit, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 478, datë 19.7.2001

PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR "SEKRET SHTETËROR" NË

RRJETET INFORMATIKE, MJETET DHE PAJISJET E TRANSMETIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 23 e 31 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I.KËRKESAT PËR RRJETET INFORMATIKE, MJETET DHE PAJISJET E TRANSMETIMIT

1. Institucionet shtetërore, të cilat për nevoja të punës duhet të prodhojnë, ruajnë, përpunojnë, shpërndajnë ose transmetojnë informacion të klasifikuar "sekret shtetëror", nëpërmjet rrjeteve informatike, mjeteve dhe pajisjeve të transmetimit, duhet t'u përmbahen rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Rrjetet informatike, mjetet dhe pajisjet e transmetimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", duhet të sigurojnë:

mbrojtjen nga ndërhyrjet e paautorizuara;

mosndryshimin e paautorizuar;

mosasgjesimin apo shkatërrimin, në mënyrë të kundërligjshme.

3. Ministria apo institucioni shtetëror, para përdorimit të rrjetit informatik, mjeteve pajisjeve të transmetimit, i kërkon DSIK-së lëshimin e "Certifikatës së sigurisë së rrjetit" apo "Certifikatës së sigurisë së mjetit".

Kërkesa shoqërore me "deklaratën e sigurisë" dhe me dokumente të tjera, që vërtetojnë dhe mbështesin sigurinë e rrjetit, të mjeteve e pajisjeve të trasmetimit.

Forma dhe përmbajtja e certifikatës dhe deklaratës së sigurisë përcaktohen nga DSIK-ja.

4. "Certifikata e sigurisë së rrjetit" është dokumenti që vërteton se tërësia e mjeteve dhe pajisjeve, që përbëjnë rrjetin ku ruhet, përpunohet, administrohet, transmetohet informacioni i klasifikuar "sekret shtetëror", plotësojnë kërkesat e sigurisë.

5. "Certifikata e sigurisë së mjetit" është dokumenti që vërteton se mjetet apo pajisjet e transmetimit plotësojnë kërkesat e sigurisë së informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror".

6. "Deklarata e sigurisë", përmban përshkrimin e plotë dhe të hollësishëm të sigurisë së rrjetit informatik, mjeteve apo pajisjeve të transmetimit, gjatë instalimit dhe shfrytëzimit. Ajo i lëshohet ministrisë apo institucionit shtetëror dhe nënshkruhet nga personi fizik apo juridik, vendas apo i huaj, i cili ka prodhuar, tregtuar, dhuruar apo siguruar ato në një mënyrë tjetër.

7. DSIK-ja brenda afatit njëmujor shqyrton kërkesën e paraqitur. Kur rrjeti informatik, mjetet apo pajisjet e transmetimit përmbushin kërkesat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, DSIK-ja lëshon "Certifikatën e sigurisë".

Në rast mosmiratimi të kërkesës, subjekti kërkues brenda 10 ditëve ka të drejtë të ankohet te Kryeministri, vendimi i të cilit është përfundimtar.

8. Personi apo personat që instalojnë, mirëmbajnë ose ndreqin rrjetin informatik, mjetet apo pajisjet e transmetimit, punonjës apo jo të institucionit, duhet të pajisen me "certifikatë sigurie".

Kur nuk janë punonjës të ministrisë apo institucionit, ata janë nën mbikqyrjen e vazhdueshme të personelit të kualifikuar teknikisht dhe të certifikuar, të ministrisë apo institucionit.

9. Kur shkëmbehet informacion i klasifikuar me shtete të tjera apo organizata ndërkombëtare, në marrëveshje mund të përcaktohen edhe standarte apo kërkesa të tjera për sigurinë e rrjeteve informatike, të mjeteve e pajisjeve të transmetimit të informacionit të klasifikuar.

II. Masat e sigurimit të rrjeteve informatike, mjeteve dhe pajisjeve të transmetimit

Sigurimi fizik i rrjeteve informatike

1. Rrjetet informatike u nënshtrohen rregullave për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", të përcaktuara me akte të tjera normative.

2. Rrjetet informatike ndërtohen në përputhje me strukturën organizative të institucionit ku instalohen dhe me nivelin e klasifikimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", që përpunohet.

3. Lidhja fizike me rrjetet lokale informatike të bëhet vetëm me media të sigurtë (fibra optike) ose me pajisje të kontrolluara, duke përdorur me shumë se një tip barriere, të cilat mbështesin njëra-

tjetrën.

4. Ndalohet përdorimi i modemave të ndryshme të cilat krijojnë lidhje të pakontrolluara me rrjetin informatik.

5. Sigurimi fizik i serverit të rrjetit lokal informatik të përputhet me nivelin e masave të sigurisë së informacionit të klasifikuar të nivelit më të lartë që ai ruan.

B. Aftësitë e sigurisë së personelit që punon me rrjetet informatike

1. Personeli që punon në rrjetet informatike, të jetë i certifikuar sipas akteve nënligjore në fuqi. Niveli i "certifikatës së sigurisë" të jetë në përputhje me nivelin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", që njeh dhe administron ky personel.

2. Personeli që punon në rrjetet informatike, të jetë i trajnuar në fushën e operimit dhe shfrytëzimit të rrjetit dhe veçanërisht në veprimet që cenojnë sigurinë e rrjetit.

3. Administratorët e rrjetit janë përgjegjës për zbatimin e masave të sigurisë së tij. Ata pajisen me "certifikatë sigurie" të nivelit më të lartë të klasifikimit të onformacionit që administrojnë dhe përzgjidhen ndër specialistët më të mirë të sistemeve të operimit e shfrytëzimit të rrjetit.

4. Personat, të cilët për nevoja pune hyjnë në mjediset me rrjete informatike, u nënshtrohen rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", të përcaktuara nga titullari i ministrisë apo institucionit.

C. Sigurimi i informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", në rrjetet informatike

1. Sigurimi i informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", në rrjetet informatike, të bëhet në të gjitha fazat e ciklit të plotë të tij.

Sistemet e transmetimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" të kenë kapacitetin dhe aftësinë që, nëpërmjet moskontakteve fizike apo elementëve speciale të software-it, të pengojnë aksesin në stacionet fundore.

2. Ndalohet ruajtja e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" në kompjuter, kur ai është i lidhur në rrjet informatik. Në këtë rast ruajtja bëhet vetëm në server.

Kompjuterat me hard disk të fiksuar, kur punojnë jashtë rrjetit dhe trajtojnë informacion të klasifikuar "sekret shtetëror", të sigurojnë nivelin maksimal të mbrojtjes, sipas klasifikimit të informacionit.

3. Masat e sigurisë dhe e drejta për t'u njohur me informacionin e klasifikuar përcaktohen sipas nivelit të klasifikimit të tij. Masat e sigurisë të parashikojnë mbrojtjen nga dëmtimet që shkaktojnë viruset e ndryshme, disiplinimin dhe kontrollin e hyrjes në rrjet dhe parandalimin e ndërhyrjeve me synime keqdashëse.

4. Përdoruesit organizohen në grupe, në përputhje me strukturën organizative dhe hierarkinë. Atyre u vihen në dispozicion llogaritë përkatëse, të cilat hapen vetëm pas përdorimit të fjalëkalimeve, të cilat ndërtohen mbi bazën e procedurave profesionale dhe ndërrohen periodikisht.

5. Përdoruesit të rrjetit informatik i ndalohet:

a) të orvatet të futet në një rrjet nën një identitet tjetër;

b) të orvatet të njohë dhe administrojë informacion të klasifikuar "sekret shtetëtror" jashtë të drejtave që ai ka;

c) të importojë apo eksportojë informacion të klasifikuar "sekret shtetëror", aplikime, lojëra me disketa etj.;

ç) të instalojë apo të ndryshojë në ndonjë mënyrë hardware-in, software-in, ose aplikime;

d. të dërgojë apo heqë informacione të klasifikuara "sekret shtetëror" ose disketa, pa autorizimin e titullarit të institucionit.

6. Rrjeti informatik i nënshtrohet kontrollit periodik, për të parë ndryshimet në rrjet, masat e sigurisë së informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" dhe përshtatjen e tyre me arritjet e kohës, nga personat përgjegjës, të caktuar nga titullari i ministrisë apo institucionit.

7. Veprimtaria e përdoruesve dhe administratorëve të rrjetit duhet të auditohet (monitorohet), për të zbuluar dhe parandaluar ngjarjet që mund të cenojnë sigurinë e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror".

8. Për të ruajtur informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" dhe konfigurimin e rrjeteve që e përpunojnë atë, bëhet rezervimi i tyre në media të ndryshme, si shirit manjetik, CD dhe server rezerve (Backup server). Për ruajtjen e këtyre pajisjeve të krijohen kushte të veçanta.

9. Prishja e autorizuar e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" të magazinuar në media të ndryshme bëhet me metoda profesionale ose me shkatërrimin fizik të tyre. Prishja të bëhet vetëm

kur është e domosdoshme dhe pasi informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror” të jetë i printuar dhe regjistruar.

Printimi dhe administrimi i dokumenteve të klasifikuara të bëhet sipas rregullave përkatëse.

10. Ndalohet trajtimi i informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, në kompjuterat private dhe futja e këtyre kompjuterave në mjediset ku ruhet, përpunohet dhe transmetohet informacion i klasifikuar.

D.Sigurimi i komunikimeve

1. Për transmetimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të përdoren mjete, pajisje e sisteme kriptografike të specializuara, fortësia e të cilave të jetë në përputhje me nivelin e klasifikimit të informacionit.

2. Drejtoria e Shifrimit dhe Transmetimit të Informacionit, e cila sot është në varësi të Shërbimit Informativ Shtetëror, është strukturë e specializuar, e cila përgjigjet për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në të gjitha strukturat shtetërore, kur ky informacion transmetohet me mjete të komunikimit, masiv e publik. Ajo përgjigjet për hartimin, prodhimin dhe përdorimin e shifrës, për të gjitha ministritë e institucionet shtetërore.

3. Përdorimi i sistemeve të shifrimit, mjeteve e pajisjeve të komunikimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të bëhet pas miratimit e certifikimit nga DSIK-ja.

III.Rregulla të veçanta

1. Ministritë dhe institucionet shtetërore janë përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në rrjetet informatike, mjetet dhe pajisjet e transmetimit.

2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Drejtuesit e këtyre institucioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, detyrohen të nxjerrin udhëzim për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 481, datë 19.7.2001

PËR PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA, PËR VITIN AKADEMIK 2001-2002, NË SISTEMIN ME SHKËPUTJE NGA PUNA SI EDHE PËR TARIFËN E SHKOLLIMIT, PO PËR VITIN AKADEMIK 2001- 2002

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 dhe 42 të ligjit nr.8461 datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqiërisë“, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kanë të drejtë të regjistrohen për konkurrim, në degën që dëshirojnë, kandidatët që kanë marrë dëftesën e pjekurisë të një shkolle të mesme, përjashtuar shkollat e arsimit të mesëm profesional 2 dhe 3 vjeçar.

2. a) kuota e pranimeve është 7512 dhe ndahet:

- kuota e përgjithshme e pranimeve të reja	7242
- kota për degë të dytë dhe vite të ndërmjetme	250
- kuota për shtetasit e huaj	20

b- Kuota e përgjithshme e pranimeve të reja përbëhet nga:

- kuota kryesore	6539

- kuota dytësore 526
- kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit 170
- kuota të veçanta për asistentë, pedagogët e SHLI-së, Tiranë 7

3. Kuota e përgjithshme e pranimeve të reja ndahet sipas shkollave të larta dhe sipas degëve të paraqitura në tabelën nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, konkurojnë ndërmjet tyre për kuotat e pranimit të përcaktuara sipas degëve të tabelës nr.2, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Për asistentë-pedagogët e Shkollës së Lartë të Infermierisë në Tiranë, caktohet 7 (shtatë) kuota për ndjekjen e studimeve, në degën infermieri, në një nga shkollat e larta të vendit, sipas udhëzimeve që do të përcaktohen në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Kuotat kryesore ndahen sipas shkollave të larta dhe sipas degëve të paraqitura në tabelën nr.3, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Kuotat dytësore, të përcaktuara në tabelën nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, u nënshtrohen tarifave të veçanta të shkollimit. Nga këto kuota përfitojnë, sipas renditjes zbritëse në listën e rezultateve të konkurimit, kandidatët që kanë konkuruar, por që nuk kanë fituar.

Vlerat e tarifave të veçanta të shkollimit për vitin akademik 2001-2002 të jenë sa ato të përcaktuara në udhëzimin nr.15, datë 9.6.2001 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave "Mbi tarifën e veçantë të shkollimit për kuotat dytësore, për vitin akademik 2000-2001", në sistemin me shkëputje nga puna".

8. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në shkollat e larta të Republikës së Shqipërisë, administrohen dhe shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesave të paraqitura pranë shkollave të larta ose Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

9. Kuotat e pranimeve për vite të ndërmjetme dhe për degë të dytë administrohen dhe shpërndahen nga Ministrisë e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të paraqitura nga shkollat e larta.

10. Kandidatët që do të vazhdojnë studimet në një degë të dytë u nënshtrohen tarifave të shkollimit. Masa e tarifës së shkollimit për degë të dytë është e barabartë me tarifën e shkollimit për kuotat dytësore, të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi.

11. Tarifa e shkollimit për vitin akademik 2001-2002 të jetë në masën 2000 (dy mijë) lekë. Kësaj tarife u nënshtrohen studentët e të gjitha viteve akademike.

12. Mënyrat e plotësimit të kuotave të parealizuara të pikës 2 të këtij vendimi përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me shkollat e larta.

13.Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës të nxjerrë udhëzimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Kuota totale e pranimeve të reja për vitin akademik 2001-2002
Tabela nr.1

Nr	Dega	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	SHLI	Σ
1	Histori	45											45
2	Gjeografi	45											45
3	Histori-Gjeografi				68	50		104					222
4	Gjuhë letërsi	71			134	50		102					357
5	Hist-Gjeog.Edukatë Qytet.				68				70				68
6	Anglisht	81			55	50	44	68					368
7	Frengjisht	60			33								93
8	Italisht	50			30			33					113
9	Gjuhe sllave ballkan	15											15
10	Gjermanisht	50			33			33					116
11	Gjuhe letersi greke	15				28							43
12	Gjuhe Turke	10											10
13	Cikli i ulët				134	50	65	203	69				521
14	Cikli i ulët parashkollor				68	50	43	104					265
15	Fizkulturë										100		100

16	Matematikë	93						69					162
17	Fizikë	81						58					139
18	Matematikë-Fizikë				86	50			32				168
19	Biologji-Kimi	57			72	50		91					270
20	Kimi e përgjithshme	30											30
21	Kimi ushqimore	32											32
22	Kimi industriale	31											31
23	Informatikë	61											61
24	Gazetari	34											34
25	Punë sociale	51											51
26	Filozofi-sociologji	42											42
27	Psikologji	33											33
28	Shkencat politike	20											20
29	Drejtësi	110						66					176
30	Art skenik									31			31
31	Arte figurative									39			39
32	Muzikë									86			86
33	Mjekësi	152											152
34	Stomatologji	44											44
35	Farmaci	32											32
36	Infermieri				60	39	108	60	95			130	492
37	Administrim-Biznes	272			110	30	42	68	69				591
38	Ekonomist	63											63
39	Financë	223			60	55	45	66					449
40	Marketing						41	60					101
41	Turizëm						40		59				99
42	Drejtimi i Ferm. dhe AGB			112									112
43	Ekon. dhe Politikë Agrare			112									112
44	Mekanike		81										81
45	Metalurgji		11										11
46	Tekstil		34										34
47	Elektrik		102										102
48	Elektronik		83										83
49	Ndërtim		123										123
50	Arkitekturë		51										51
51	Hidroteknikë		52										52
52	Topogjeodezi		20										20
53	Inxhinieri ambienti		36										36
54	Gjeol.Min/Ngurtë		30										30
55	Gjeofizikë		20										20
56	Inxhinieri nafte		25										25
57	Miniera		25										25
58	Inxhinieri detare								25				25
59	Navigacion								35				35
60	Zootekni dhe Biznes bleg.			22									22
61	Akuakul. dhe Menaxh.pe.			22									22
62	Veterinari			71									71
63	Prodhim bimor			48									48
64	Mbarështrim dhe Shfr.Pyj.			49									49
65	Industria e Drurit			37									37
66	Hortikulturë			34									34
67	Teknolog ushqimor			39									39
68	Konservim,përp.prod.bujq			20									20
69	Agro Mjedis			25									25
70	Vreshtari-Enologji			20									20
71	Inxhinieri agronomike						62						62
	TOTALI	1903	693	611	1011	502	490	1185	454	156	100	130	7235

Kuota e veçanta për kandidatë nga trojet jashtë kufijve të vendit për vitin akademik 2001-2002
Tabela nr.2

Kuota kryesore për pranimet e reja për vitin akademik 2001-2002

Tabela nr.3

Nr	Dega	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	SHLI	Σ
1	Histori	36											36
2	Gjeografi	36											36
3	Histori-Gjeografi				60	45		90					195
4	Gjuhë letërsi	63			120	45		90					318
5	Hist-Gjeog.Edukatë Qytet.				60								60
6	Anglisht	72			50	45	40	60	63				330
7	Frengjisht	54			30								84
8	Italisht	45			30			30					105
9	Gjuhe sllave ballkan	15											15
10	Gjermanisht	45			30			30					105
11	Gjuhe letersi greke	13				25							38
12	Gjuhe Turke	10											10
13	Cikli i ulët				120	45	60	180	63				468
14	Cikli i ulët parashkollor				60	45	40	90					235
15	Fizkulturë										91		91
16	Matematikë	90						60					150
17	Fizikë	79						50					129
18	Matematikë-Fizikë				75	50			30				155
19	Biologji-Kimi	52			65	45		80					242
20	Kimi e përgjithshme	30											30
21	Kimi ushqimore	28											28
22	Kimi industriale	30											30
23	Informatikë	51											51
24	Gazetari	27											27
25	Punë sociale	45											45
26	Filozofi-sociologji	36											36
27	Psikologji	28											28
28	Shkencat politike	18											18
29	Drejtësi	100						60					160
30	Art skenik									31			31
31	Arte figurative									37			37
32	Muzikë									86			86
33	Mjekësi	130											130
34	Stomatologji	36											36
35	Farmaci	25											25
36	Infermieri				60	35	100	60	86			114	455
37	Administrim-Biznes	240			100	30	40	60	63				533
38	Ekonomist	60											60
39	Financë	200			60	50	40	60					410
40	Marketing						40	60					100
41	Turizëm						40		54				94
42	Drejtimi i Ferm. dhe AGB			100									100
43	Ekon. dhe Politikë Agrare			100									100
44	Mekanike		80										80
45	Metalurgji		10										10
46	Tekstil		30										30
47	Elektrik		90										90
48	Elektronik		72										72
49	Ndërtim		108										108
50	Arkitekturë		45										45
51	Hidroteknikë		50										50
52	Topogjeodezi		20										20
53	Inxhinieri ambienti		31										31
54	Gjeol.Min/Ngurtë		30										30
55	Gjeofizikë		20										20
56	Inxhinieri nafte		25										25
57	Miniera		25										25
58	Inxhinieri detare								23				23
59	Navigacion								33				33
60	Zootekni dhe Biznes blegt			20									20

61	Akuakult dhe Menaxh.pe.			20									20
62	Veterinari			60									60
63	Prodhim bimor			40									40
64	Mbarështrim dhe Shfr.Pyj.			40									40
65	Industria e Drurit			30									30
66	Hortikulturë			30									30
67	Teknolog ushqimor			30									30
68	Konservim,përp.prod.bujq			20									20
69	Agro Mjedis			25									25
70	Vreshtari-Enologji			20									20
71	Inxhinieri agronomike						60						60
	TOTALI	1694	636	535	920	460	460	1060	415	154	91	114	6539

Kuota dytësore për vitin akademik 2001-2002
Tabela nr.4

Nr	Dega	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	SHLI	Σ
1	Histori	4											4
2	Gjeografi	4											4
3	Histori-Gjeografi				6	5		9					20
4	Gjuhë letërsi	6			12	5		9					32
5	Hist-Gjeog.Edukatë Qytet.				6								6
6	Anglisht	7			5	5	4	6	7				34
7	Frengjisht	6			3								9
8	Italisht	5						3					8
9	Gjuhe sllave ballkan												0
10	Gjermanisht	5			3			3					11
11	Gjuhe letersi greke	2				3							5
12	Gjuhe Turke												0
13	Cikli i ulët				12	5	5	18	6				46
14	Cikli i ulët parashkollor				6	5	3	9					23
15	Fizkulturë										9		9
16	Matematikë							6					6
17	Fizikë							5					5
18	Matematikë-Fizikë				8				2				10
19	Biologji-Kimi	5			7	5		8					25
20	Kimi e përgjithshme												0
21	Kimi ushqimore												0
22	Kimi industriale												0
23	Informatikë	5											5
24	Gazetari	3											3
25	Punë sociale	5											5
26	Filozofi-sociologji	4											4
27	Psikologji	3											3
28	Shkencat politike	2											2
29	Drejtësi	10						6					16
30	Art skenik												0
31	Arte figurative												0
32	Muzikë												0
33	Mjekësi	13											13
34	Stomatologji	4											4
35	Farmaci	3											3
36	Infermieri					4	6		9			11	30
37	Administrim-Biznes	30			10		2	6	6				54
38	Ekonomist												0
39	Financë	20				5	4	6					35
40	Marketing												0
41	Turizëm								5				5
42	Drejtimi i Ferm. dhe AGB			10									10
43	Ekon. dhe Politikë Agrare			10									10
44	Mekanike												0

45	Metalurgji												0
46	Tekstil												0
47	Elektrik		9										9
48	Elektronik		8										8
49	Ndërtim		11										11
50	Arkitekturë		5										5
51	Hidroteknikë												0
52	Topogjeodezi												0
53	Inxhinieri ambienti		3										3
54	Gjeol.Min/Ngurtë												0
55	Gjeofizikë												0
56	Inxhinieri nafte												0
57	Miniera												0
58	Inxhinieri detare								2				2
59	Navigacion								2				2
60	Zootekni dhe Biznes blegt			2									2
61	Akuakult dhe Menaxh.pe.			2									2
62	Veterinari			6									6
63	Prodhim bimor			4									4
64	Mbarështrim dhe Shfr.Pyj.			4									4
65	Industria e Drurit			3									3
66	Hortikulturë			3									3
67	Teknolog ushqimor			3									3
68	Konservim,përp.prod.bujq												0
69	Agro Mjedis												0
70	Vreshtari-Enologji												0
71	Inxhinieri agronomike												0
	TOTALI	146	36	47	78	42	24	94	39	0	9	11	526

U D H Ë Z I M
Nr.6, datë 19.7.2001

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.4, DATË 22.8.1994, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR VLERËSIMIN E APARTAMENTEVE, QË NDËRTOHEN ME FONDE SHTETËRORE", NDRYSHUAR ME UDHËZIMIN NR.1, DATË 12.1.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

Në udhëzimin nr.4, datë 22.8.1994 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me udhëzimin nr.1, datë 12.1.2001 të Këshillit të Ministrave, në paragrafin e parë, shkronja "d" pika 9, pas fjalëve "Për ushtarakët…" të shtohen edhe fjalët "…dhe punonjësit e Ministrisë së Rendit Publik…", dhe pas fjalëve "…Ministrisë së Mbrojtjes…" të shtohen fjalët "… dhe Ministrisë së Rendit Publik…"

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.59, datë 4.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“”
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“”
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“”
Kujtim Puto,	Anëtar i	“”
Petrit Plloçi,	Anëtar i	“”
Tefta Zaka,	Anëtare e	“”
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“”
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“”

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 4.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.72 Akti që i përket:

KËRKUES: MENTOR BUNGURI

SUBJEKTE TE INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj, me autorizim.

2. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.20, në mungesë.

3. ILIR GJONI, kandidat për deputet, përfaqësuar me prokurë nga avokatët Ilir Panda e Mirash Martini.

O B J E K T I:

Pavlefshmëria e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për zonën zgjedhore nr.20 Dibër, të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.970, datë 29.6.2001

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.970, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është shpallur rezultati përfundimtar i zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.20, duke njohur fitues kandidatin për deputet Ilir Gjoni.

Në kërkesën e tij për pavlefshmëri të rezultatit përfundimtar, kërkuesi Mentor Bunguri pretendon se gjatë procesit zgjedhor janë kryer një sërë shkeljesh që kanë të bëjnë me përcaktimin e listave të zgjedhësve, afatin e shpalljes së tyre, ndarjen e saktë të zonës, largimin dhe zëvendësimin e një anëtari të komisionit të zonës zgjedhore, konstituimin e komisioneve të qendrave të votimit, hapjen e kutive të votimit, vula të paregjistruara në procesverbal si dhe presionet dhe dhunën e ushtruar gjatë fushatës elektorale.

Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e kërkuesit nuk mbështeten në prova për të argumentuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Për më tepër, disa nga këto pretendime si për parregullsitë në listat e zgjedhësve, konstituimin e komisioneve të qendrave të votimit etj., kanë të bëjnë me procesin parazgjedhor për të cilat duhet të ishte bërë ankim sipas ligjit.

Të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera të kërkuesit. Zëvendësimi i një anëtari të komisionit të zonës zgjedhore është bërë me propozim të subjektit përkatës. Pretendimet për hapjen e kutive të votimit, për ushtrim presioni e dhune nuk provohen përderisa në procesverbalet e qendrave të votimit nuk janë bërë vërejtje nga anëtarët e komisionit.

Pretendimi tjetër i kërkuesit është se ndarja zonale është bërë me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kur duhej të bëhej me ligj. Në fakt me vendim të Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve është bërë vetëm ndarja e qendrave të votimit të Komunës Tomin, pasi për këtë kanë rënë dakord komisionet e zonave zgjedhore nr.20 e 21. Sipas këtij vendimi me nr.786/1, datë 2.6.2001 duke u nisur nga pozita gjeografike dhe duke marrë në konsideratë numrin e zgjedhësve të fshatrave të komunës, në zonën zgjedhore nr.20 miratohen 8 qendra votimi me 3 257 zgjedhës, ndërsa në zonën zgjedhore nr.21 miratohen 9 qendra votimi me 3 326 zgjedhës. Gjithësesi një ndarje e tillë jo vetëm që nuk ka sjellë asnjë ndikim në rezultatin e zgjedhjeve, por është edhe zgjidhja më e mirë e mundshme duke u bazuar edhe në pëlqimin e komisioneve të zonave zgjedhore përkatëse.

Në këto kushte duhet të vendoset rrëzimi i kërkesës.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, nenit 141 të Kodit Zgjedhor si dhe neneve 26, 66, 67 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.80, datë 12.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 5.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.78 Akti që i përket:

KËRKUES: ARIAN STAROVA, përfaqësuar me deklarim nga avokat Arben Ristani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. ET'HEM RUKA, përfaqësuar me prokurë nga avokat Përparim Sanxhaku.

O B J E K T I:

1. Shfuqizimi i vendimit nr.007, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të zgjedhjeve, që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.40 dhe i vendimit nr.16, datë 27.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.40.
2. Urdhërimi i raundit të dytë të zgjedhjeve për zhvillimin e balotazhit në zonën zgjedhore nr.40

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 113 dhe 141 të Kodit Zgjedhor

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.007, datë 30.6.2001 njohu fitues Et'hem Rukën kandidatin për deputet të Partisë Socialiste, duke lënë kështu në fuqi vendimin nr.16, datë 27.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.40.

Kandidati për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore", Arian Starova me kërkesën e paraqitur për shqyrtim kësaj Gjykate ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të mësipërme dhe urdhërimin e raundit të dytë të zgjedhjeve për zonën zgjedhore nr.40 për t'u zhvilluar balotazhi ndërmjet tij dhe kandidatit tjetër Et'hem Ruka.

Kërkuesi pretendoi se Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.40 që shpalli Et'hem Rukën deputet padrejtësisht mori për bazë të dhënat e tabelës të noterizuar model 54 të qendrës së votimit nr.185, sepse këto të dhëna nuk janë të vërteta. Ky komision sipas kërkuesit duhet të merrte për bazë të dhënat e tabelave origjinale model 54 dhe 56 që u gjendën brenda kutisë të qendrës së votimit nr.185, të dhëna të cilat e çojnë pa asnjë kushtëzim zonën 40 në zgjedhjet e raundit të dytë në balotazh.

Për verifikimin e këtij pretendimi gjykata pasi ftoi palët për paraqitjen e tabelave origjinale, bëri krahasimin e tabelës origjinale model 54 me nr.serie 065613 të rezultateve të qendrës së votimit nr.185, paraqitur nga kërkuesi Arian Starova, me tabelën origjinale model 54 nr.serie 065612, të rezultateve të qendrës së votimit nr.185, paraqitur nga përfaqësuesi i kandidatit Et'hem Ruka.

Nga krahasimi i dy tabelave të paraqitura në seancën gjyqësore rezultoi se ato janë të firmosura nga të njëjtët komisionerë e përfaqësues, por kanë rezultate të ndryshme dhe janë shkruar jo nga i njëjti person. Konkretisht, në tabelën paraqitur nga kërkuesi me nr.serie 065613 shënohen 658 fletë votimit të vlefshme, kurse në tabelën tjetër me nr.serie 065612, paraqitur nga përfaqësuesi i subjektit të interesuar Et'hem Ruka, shënohen 621 fletë votimi të vlefshme. Pra, nga krahasimi i këtyre të dhënave me një përllogaritje të thjeshtë del se në tabelën 45 me nr.serie 065612 janë shënuar më pak 37 fletë votimi të vlefshme, shifër kjo e mjaftueshme për shpalljen e deputetit dhe për moskalimin në balotazh të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.40.

Por, gjatë gjykimit rezultoi se krahasimi i tabelave dhe vlerësimi i tyre është bërë objekt diskutimi në Komisionin e Zonës Zgjedhore para se të shpallej rezultati përfundimtar i zgjedhjeve në këtë zonë. Ky Komision me vendimin nr.15, datë 25.6.2001, bazuar në kërkesën e përfaqësuesit të Partisë Socialiste, me shumicë votash, mospërputhjen e tabelave të mësipërme e ka zgjidhur në favor të tabelës 54 me nr.serie 065612 paraqitur nga Partia Socialiste duke e quajtur atë të vlefshme dhe jo tabelën që dispononte Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.40.

Meqenëse nga Gjykata, argumentet mbi të cilat mbështetet vendimi nr.15, datë 26.6.2001 i Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.40, nuk u konsideruan të mjaftueshme dhe bindëse, atëherë u pa e nevojshme që si kërkuesi ashtu dhe subjektet e interesuara të paraqesnin për krahasim dokumente të tjera siç janë tabelat model 54 me nr.serie vazhdues që u janë shpërndarë sipas rregullit subjekteve të tjera të zonës dhe tabelat model 54 të kutisë e të zarfit që shoqëronte kutinë nga qendra e votimit nr.185 në Komisionin e Zonës Zgjedhore. Mirëpo, këto tabela të cilat kishin rëndësi të veçantë për zbulimin e së vërtetës nuk u paraqitën as nga kërkuesi as edhe nga subjektet e interesuara.

Në këto kushte Gjykata vendosi të hapë kutinë e qendrës së votimit nr.185 të zonës zgjedhore nr.40, për të bërë numërimin e votave. Nga hapja e kësaj kutie në prani të palëve, rezultoi se pas numërimit në këtë qendër votimi u gjetën 674 vota të vlefshme, pra një numër votash më i madh se ai i tabelës paraqitur nga kërkuesi Arian Starova dhe se ai i tabelës së paraqitur nga Partia Socialiste dhe kandidati Et'hem Ruka.

Nisur nga numri i fletëve të votimit të vlefshme që u gjetën prej Gjykatës Kushtetuese në kutinë e qendrës së votimit nr.185 të zonës zgjedhore nr.40, kjo Gjykatë arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga Arian Starova rezultoi e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja "e" dhe 132 të Kushtetutës, në nenet 26 dhe 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe në nenin 113 pika 5 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.007, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar në zonën zgjedhore nr.40;

- Urdhërimin e zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve midis kandidatit për deputet Et'hem Ruka dhe kandidatit për deputet Arian Starova.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.81, datë 7.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka.	Anëtare e	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""

me sekretare Drita Panda, në datën 7.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.92 Akti që i përket:

KËRKUES: NDREKË RUKAJ, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar me deklarim nga avokat Arben Hakani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. VALENTINA PALAJ
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.4, përfaqësuar nga kryetari Ernest Rukaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi I vendimit nr.096, datë 3.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore nr.4:

- Komisioni i Zonës Zgjedhore nr. 4 për një pjesë të qendrave të votimit ka nxjerrë rezultatin mbi bazën e procesverbaleve të trukuara dhe kuti votimi të hapura e të dhunuara.

- Në mjaft qendra votimi pasqyrohet sikur kanë votuar zgjedhës që nuk janë në Shqipëri, janë përdorur fletëvotimi më tepër se sa kanë qenë zgjedhës që kanë votuar, janë hedhur në kuti fletëvotimi që nuk i përkasin asaj qendre, ka votuar një person në emër të gjithë familjes, etj.

- Dokumentacioni, në mjaft raste, nuk pasqyron elementet thelbësorë të procesit zgjedhor të qendrës së votimit, si psh.: numrin e personave që kanë votuar, numrin e fletëvotimeve të gjetura në kutinë e votimit, numrin e fletëvotimeve të vlefshme, numrin e fletëvotimeve të pavlefshme etj.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, pretendimet e kërkuesit e të subjekteve të interesuara, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.4 Shkodër ka nxjerrë rezultatin e zgjedhjeve të 24 qershorit 2001 dhe ka shpallur si deputet të drejtpërdrejtë në atë zonë zotin Valentin Palaj. Kundër këtij vendimi kërkuesi është ankuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ky i fundit, me vendimin nr.005, datë 1.7.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.4, ka shpallur të pavlefshme zgjedhjet në 6 qendra votimit dhe ka urdhëruar përsëritjen e tyre në këto qendra. Pas dhënies së këtij vendimi kërkuesi është ankuar përsëri duke kërkuar përsëritjen e votimit jo vetëm në 6 qendra votimi, por në 18 qendra të tilla dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.096, datë 3.7.2001, ka vendosur mospranimin për shqyrtim të kërkesës, me arsyetimin se nuk ka prova për vërejtjet e bëra nga ankuesi.

Vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk vijnë në kundërshtim me ligjin e me provat. Përderisa kërkuesi kërkon shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Zonës Zgjedhore ka detyrimin të paraqesë provat përkatëse që vërtetojnë manipulimin e rezultateve të votimeve në atë zonë. Kodi Zgjedhor ka parashikuar dokumentet që përbëjnë prova të plota, siç janë procesverbalet e komisioneve të qendrave të votimit e të komisionit të zonës, në të cilat jo vetëm që çdo subjekt elektoral ka të drejtë të pasqyrojë vërejtjet përkatëse, por ka të drejtën të marrë edhe një kopje të këtyre procesverbaleve. Kërkuesi nuk paraqiti dokumente të tilla. Në të kundërtën, subjekti i interesuar Valentin Palaj paraqiti procesverbalet e komisioneve të qendrave të votimit e të komisionit të zonës nga të cilat del se komisionerët e subjektit elektoral, Partia Socialiste, i kanë pranuar rezultatet e votimit pa bërë asnjë vërejtje.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konkludon se vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për rezultatet e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.4, nuk vijnë në kundërshtim me ligjin e janë të bazuara në prova dhe kërkesa e kërkuesit Ndrekë Rukaj për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore nr.4, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 të Kushtetutës; neneve 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 113 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.82, datë 18.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.102 Akti që i përket:

KËRKUES: 1. LEKË ÇUKAJ, kandidat për deputet i Partisë Socialiste.
2. MARK KROQI, përfaqësohet me deklarim nga avokat Bujar Hoti.
SUBJEKTE TË INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr.171, datë 13.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin pjesërisht të vendimit të mësipërm:
Kërkuesi Lekë Çukaj:
- Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në 13 qendra votimi është pjesërisht i pabazuar në ligj e në të gjitha materialet që disponon Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.2 Shkodër dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Tiranë.
- Në 8 qendra votimi: nr.10 Postribë; nr.1, 2, 5, 7, 9 Shalë; nr.1 Shllak e nr.9 Temal janë zhvilluar rregullisht zgjedhjet pa u bërë vërejtje nga anëtarët e komisionit.
Kërkuesi Mark Kroqi:
- Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pa të drejtë ka nxjerrë të pavlefshme votimet në qendrat e votimit nr.3 Shkrel; nr.9 Temal; nr.2, 5 e 6 Shllak e nr.1 Shalë.
- Nuk jemi para rasteve që parashikon neni 113 i Kodit Zgjedhor për pavlefshmërinë e votimit në këto qendra sepse nuk ka shkelje të ligjit. Të gjithë komisionerët kanë nënshkruar pa vërejtje procesverbalet e këtyre qendrave të votimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuesit dhe përfaqësuesit e tyre, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, u njoh me përmbajtjen e dokumenteve të dosjes dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.171, datë 13.7.2001 ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.2 dhe ka shpallur të pavlefshme zgjedhjet në qendrat e votimit nr.3 Shkrel; nr.10 e 14 Postribë; nr.1, 2, 5, 7, 9 Shalë; nr.1, 2, 5, 6 Shllak si dhe në qendrën e votimit nr.9 Temal, duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në këto qendra votimi në datën 22 korrik 2001.
Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i drejtë. Procesi i votimit në të 13 qendrat e votimit është kryer me mangësi e parregullsi të shumta të cilat kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve në disa qendra votimi. Për më tepër, në Komisionin e Zonës Zgjedhore kutitë e votimit kanë ardhur të hapura gjë që vërteton pretendimet e kërkuesit Lekë Çukaj për parregullsi e shkelje ligji në 6 qendra votimi si dhe pretendimet e kërkuesit Mark Kroqi për parregullsi e shkelje ligji në 8 qendra votimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/e të Kushtetutës; neneve 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” si dhe nenit 113 të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesave.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk është i bazuar në ligj e në prova përsa i

përket shpalljes së pavlefshme të zgjedhjeve në qendrat e votimit nr.1 Shalë, nr.9 Temal, nr.10 Postribë dhe nr.1 Shllak.

Të dy kandidatët rivalë për deputet pranuan se si votimi ashtu edhe tabelat e rezultateve në qendrat e votimit nr.1 Shalë dhe nr.9 Temal janë në konformitet me Kodin Zgjedhor. Si rrjedhojë duke mos pasur asnjë kundërshtim nga të dy palët dhe asnjë vërejtje nga komisionerët në qendrat e votimit e në zonën zgjedhore, nuk është e legjitimuar shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve dhe përsëritja e tyre në këto dy qendra votimi. Konstatimi se këto kuti votimi kanë ardhur të hapura në Komisionin e Zonës Zgjedhore nuk të çon në çdo rast në shpalljen të pavlefshëm të votimit. Në këtë rast votimi mund të konsiderohet i tillë kur subjektet elektorale (përfshi edhe kandidatët) kontestojnë procesverbalet për tabelat e rezultateve apo vendimet përkatëse të komisioneve por jo kur ata pranojnë si të vërteta rezultatet e shënuara në to.

Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vjen në kundërshtim me ligjin e provat edhe përsa i përket urdhërimit për rivotim në qendrën e votimit nr.10 Postribë. Në këtë të fundit zgjedhjet janë zhvilluar normalisht dhe rezultati është pranuar nga anëtarët e Komisionit të Qendrër së Votimit dhe anëtarët e Komisionit të Zonës Zgjedhore, përfshirë edhe anëtarët e koalicionit "Bashkimi për Fitore", të cilët i kanë pranuar rezultatet duke mos bërë asnjë vërejtje. Për më tepër, nga procesverbali i mbajtur në takimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me Komisionin e Zonës Zgjedhore nr.2, del se kutia e votimit ka ardhur e rregullt në Komisionin e Zonës Zgjedhore.

Zgjedhjet nuk duhet të përsëriten edhe në qendrën e votimit nr.1 Shllak sepse për zhvillimin normal të tyre pretendon jo vetëm kandidati socialist Lekë Çukaj, por edhe kandidati rival Mark Kroqi, duke paraqitur deklaratën noteriale (nr.447 Rep. E nr.409 Kol., datë 16.7.2001) të zv/kryetarit të qendrës së votimit, Tom Zojza. Ky i fundit ka nënshkruar pa vërejtje edhe tabelën përkatëse të rezultateve të asaj qendre.

ANËTAR
K. Puto

V E N D I M
Nr.83, datë 20.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 19.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.104 Akti që u përket:

KËRKUES: LUAN HAJDARAGA, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.36, përfaqësuar nga avokat Artan Tabaku.

SUBJEKTE Të INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në mungesë.

2. EDI PALOKA, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.36, përfaqësuar nga avokat Arben Ristani.

3. KOMISIONI I ZONES ZGJEDHORE NR.36, përfaqësuar nga kryetarja Suela Morina.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.178, datë 17.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Luan Hajdaraga ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese ku pretendon se vendimi nr.178, datë 17.7.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.36, është i pambështetur në ligj e në prova e si i tillë duhet të shfuqizohet e për pasojë zgjedhjet në këtë zonë të shpallen të pavlefshme.

Nga shqyrtimi i materialeve të çështjes ka rezultuar e provuar se kërkuesi nuk rezulton të ketë bërë ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj vendimit nr.18, datë 13.7.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.36, që shpalli rezultatet e zgjedhjeve, si dhe kandidatin fitues zotin Edi Paloka. Në këtë mënyrë, kërkuesi është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese pa konsumuar mjetet e tjera ligjore të ankimit në rrugën administrative e për pasojë, në kuptim të nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës dhe neneve 107 e 140 të Kodit Zgjedhor nuk legjitimohet të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronjat "e dhe f" të Kushtetutës, si dhe nenit 140 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.84, datë 12.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 12.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.89 Akti që i përket:

KËRKUES: NDUE LAZER PJETRA, kandidat për deputet i Partisë Socialdemokrate, përfaqësuar me deklarim nga avokat Lazër Preng Zefi.

SUBJEKTE TE INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.

2. PJETËR ARBNORI, kandidat për deputet, i pavarur, mbështetur nga PD+BF, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.988, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përsëritja e zgjedhjeve në 5 qendra votimi

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Në qendrën e votimit nr.9 Kosmaq të Komunës Bushat nuk janë bërë votimet dhe procesverbali është nënshkruar nga një person i vetëm, duke falsifikuar format e anëtarëve të tjerë të komisionit të qendrës së votimit.
- Në qendrën e votimit Stajka, 51 banorë të këtij fshati ndodhen jashtë shtetit dhe figurojnë se kanë votuar.
- Në qendrën e votimit Mjedë, 72 persona të regjistruar në këtë qendër votimit ndodhen jashtë shtetit dhe figurojnë në procesverbale se kanë votuar.
- Në qendrën e votimit Melgushe, 29 persona në qendrën e votimit të Komunës Vig Mnele, 13 persona dhe në qendrën e votimit Ashtë 17 persona ndodhen jashtë shtetit dhe figurojnë sikur kanë votuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Tefta Zaka, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, subjektin e interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.988, datë 29.6.2001, ka shpallur rezultatin në zonën zgjedhore nr.3, duke njohur si fitues kandidatin e pavarur për deputet, zotin Pjetër Arbnori.

Në tabelën përmbledhëse model 39/1 të rezultateve të zonës zgjedhore nr.3, kërkuesi figuron i katërti dhe me një diferencë prej 7 593 votash me subjektin e interesuar zotin Pjetër Arbnori, kandidat i pavarur për deputet i mbështetur nga koalicioni “Bashkimi për Fitore”.

Kërkuesi ka pretenduar se, në qendrën e votimit nr.9 Kosmaq, Komuna Bushat, nuk janë bërë zgjedhje dhe procesverbali është nënshkruar nga një person i vetëm, duke falsifikuar nënshkrimet e anëtarëve të tjerë të komisionit. Sipas kërkuesit, Komisioni i Zonës Zgjedhore e ka përfshirë këtë procesverbal në rezultatin përfundimtar.

Pretendimi i kërkuesit nuk qëndron sepse në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve Model 39/1 është pasqyruar vërejta e Kryetarit të Komisionit të Zonës Zgjedhore për këtë qendër votimi dhe Komisioni i Zonës Zgjedhore e ka pranuar, duke vendosur të mos përfshijë në rezultatet e tabelës përmbledhëse, procesverbalet e qendrës së votimit nr.9, Komuna Bushat, meqenëse ishin pa nënshkrimet e anëtarëve të komisionit të kësaj qendre votimi.

Pretendimi i kërkuesit se kanë votuar banorë të cilët banojnë aktualisht jashtë shtetit, në qendrat e votimit në Stajkë, Mjedë, Melgushë, Vig Menelë dhe Ashtë, nuk u provua në seancë gjyqësore prej tij. Por, edhe po të ishte provuar, numri i personave të pretenduar është 180 dhe nuk ndikon në ndarjen e mandateve në Kuvend, kërkesë e nenit 113/a të Kodit Zgjedhor, për arsye se diferenca midis kërkuesit dhe subjektit të interesuar është 7 593 vota.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se vendimi nr.988, datë 29.6.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “e” dhe 132 të Kushtetutës; nenet 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenin 140 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.85, datë 10.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 10.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.86 Akti që i përket:

KËRKUES: AGRON AGALLIU, kandidat për deputet i subjektit politik "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar me prokurë nga Ilir Rusmajli.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.

2. YLLI BUFI, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokatët Ilir Panda e Mirash Martini, me prokurë.

3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.67, përfaqësuar nga zonja Vjollca Bita.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.946, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

BAZA LIGJORE: Nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Komisionerët e Partisë Socialiste, Partisë Socialdemokrate dhe Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, kanë shpallur rezultatin duke u mbështetur në procesverbale të falsifikuara në disa prej qendrave të votimit.

- Në qendrën e votimit nr.12, është marrë për bazë një procesverbal i falsifikuar i ndryshëm në rezultat nga procesverbali që ne disponojmë. I njëjti fenomen ka ndodhur edhe në qendrat e votimit nr.25 dhe nr.26.

- Në qendrën e votimit nr.3, komisionerët e koalicionit "Bashkimi për Fitore" janë detyruar të largohen nga qendra e votimit nën kërcënimin e militantëve e komisionerëve socialistë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.946, datë 28.6.2001 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore nr.67, duke njohur si fitues kandidatin për

deputet të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zotin Ylli Bufi. Kërkuesi Agron Agalliu, në bazë të nenit 141/1 të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar në Gjykatën Kushtetuese shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Gjatë gjykimit rezultoi se kërkuesi nuk ka paraqitur ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kundër vendimit nr.1, datë 26.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhor nr.67. Në bazë të nenit 140/2 të Kodit Zgjedhor vendimet e Komisionit të Zonës Zgjedhor, me përjashtim të atyre që parashikohen në pikën 1 të këtij neni, mund të ankimohen brenda 2 (dy) ditëve nga shpallja e tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i cili vendos mbi ankimin brenda 2 (dy) ditëve nga shpallja e tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa sipas nenit 141/1, vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve si dhe pavlefshmërinë e tyre, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tyre.

Pra siç shihet, Kodi Zgjedhor si procedurë fillestare për zgjidhjen e konflikteve zgjedhore ka parashikuar procedurën administrative dhe vetëm pas kësaj mund të konsumohet procedura gjyqësore. Në rastin në shqyrtim, përderisa kërkuesi nuk e ka konsumuar rrugën administrative për të kundërshtuar vendimin e Komisionit të Zonës Zgjedhore, ai nuk legjitimohet për të kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuesit Agron Agalliu duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës; nenit 141/1 të Kodit Zgjedhor si dhe neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa nuk duhej rrëzuar pa një hetim të plotë të pretendimeve të kërkuesit e që kishin të bënin me goditjen për falsitet të të dhënave që përmbante tabela e rezultateve Model 39/1 hartuar nga Komisioni i Zonës Zgjedhore për qendrat e votimit nr.12 e 25.

Në radhë të parë, shumica duhej të kishte parasysh se procesverbali Model 54 që mbahet nga komisionet e qendrave të votimit, është dokumenti bazë që pasqyron rezultatin e verifikimit direkt të fletëve të votimit dhe të numërimit të votave sipas nenit 196 të Kodit Zgjedhor, kurse tabela Model 39/1 është përmbledhëse që Komisioni i Zonës Zgjedhore harton mbi bazën e procesverbaleve të mësipërme.

Në rastin në shqyrtim, kërkuesi paraqitti dy procesverbale Model 54 që i përkisnin qendrave të votimit nr.12 e 25, të cilat kishin të dhëna të ndryshme nga tabela Model 39/1 vetëm përsa i përket votave por zotit Ylli Bufi. Kështu, diferenca për qendrën e votimit nr.12 ishte për 72 vota, për qendrën e votimit nr.25 ishte për 230 vota.

Veç kësaj, kërkuesi pretendoi se tabela e Komisionit të Zonës Zgjedhore Model 39/1 është nënshkruar vetëm nga katër anëtarë dhe se veç shifrave të mësipërme kjo tabelë nuk pasqyron realitetin dhe përsa i përket numurit të përgjithshëm të qendrave të votimit. Kështu, nga 30 qendra votimi që pati zona nr.67, komisioni i zonës në tabelë pasqyron sikur janë 29 qendra votimi.

Në kushtet kur të dhënat e tabelës nr.39/1 goditen për falsitet, duke paraqitur dokumenta të cilat përbëjnë provë shkresore (procesverbalet Model 54 të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit e të vulosura rregullisht); kur diferenca e votave të përmendura më lart ka qenë vendimtare në shpalljen fitues të zotit Ylli Bufi (i cili vetëm për 149 vota ka kaluar kufirin e balotazhit) ishte detyrë imperative e Gjykatës t’i shkonte të vërtetës deri në fund.

Përkundrazi, shumica, pa asnjë argument bindës nuk shtrin verifikimin gjyqësor në dokumentet autentike e origjinale që normalisht duhet të përmbanin të dy kutitë e votimit të

depozituara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Një hetim i tillë i pamjaftueshëm, duke i dhënë apriori prevalencë një dokumenti të prejardhur e me përmbajtje të dyshimtë ndaj dokumentit origjinal, e bën vendimin e shumicës të pambështetur në prova e në ligj.

ANËTAR
A.Karamuço

V E N D I M
Nr.86, datë 18.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.101 Akti që i përket:

KËRKUESA: 1. NDRE LEGISI, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Partia Socialiste, përfaqësuar me deklarim nga Fatmir Gjika.

2. KOLIN HIL GJOKA, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar me prokurë nga juristi Vladimir Mulaj.

SUBJEKTE TE INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. KOMISIONI I ZONES ZGJEDHORE NR.14, përfaqësuar nga zoti Zef Prenga

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.172, datë 13.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor

Për shfuqizimin e vendimit, kërkuesi Ndre Legisi ka parashtruar këto shkaqe:

- Me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk jam dakord pjesërisht. Lidhur me qendrën e votimit nr.13 të zonës zgjedhore nr.14, jam dakord me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pasi aty, janë zhvilluar zgjedhje. Ndërsa në qendrën e votimit nr.12, votimi është kryer plotësisht konform Kodit Zgjedhor. Në këtë qendër votimi pas një votimi normal, në orën 18.00 është mbyllur qendra dhe pas kësaj ka filluar numërimi i votave. Në përfundim ka rezultuar se kanë votuar 244 votues, nga të cilët 120 për Kolin Gjokën, 104 për Ndre Legisin dhe 20 fletëvotimi të pavlefshme. Kur duhej të firmosej procesverbali nga komisioni, kanë lindur mosmarrëveshje për 20 fletëvotimet e pavlefshme. Meqë nuk janë marrë vesh, anëtarët e komisionit të qendrës së votimit nr.12 kanë shkuar për sqarim në Komisionin e Zonës Zgjedhore nr.14 në qytetin e Rrëshenit. Komisioni i Zonës Zgjedhore ka marrë në dorëzim kutitë, por përsëri nuk ka nxjerrë rezultat. Për këtë rast është njoftuar edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Meqenëse anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe Komisionit të Zonës Zgjedhore nuk kanë kryer detyrën e tyre ligjore për nxjerrjen e rezultatit, kurse të gjitha veprimet e tjera janë kryer konform Kodit Zgjedhor, kërkojmë hapjen e kutisë së votimit të

qendrës së votimit nr.12, nxjerrjen e rezultatit dhe përfshirjen e tij në rezultatin e Zonës Zgjedhore nr.14.

Kërkuesi Kolin Hil Gjoka ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e pjesëshëm të vendimit të sipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

- Ky vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i paplotë sepse duhet të ishte vendosur përsëritja e zgjedhjeve edhe në qendrën e votimit nr.3, fshati Kuzhnen të Komunës Kaçinar dhe në qendrën e votimit nr.1 fshati Kalur të Komunës Kashnjet.

Për qendrën e votimit nr.3 fshati Kuzhnen Komuna Kaçinar, sipas procesverbalit të marrë parasysh në nxjerrjen e rezultatit nga Komisioni i Zonës Zgjedhore, kandidati Ndre Legisi ka marrë 181 vota, ndërsa kandidati Kolin Gjoka ka marrë 37 vota. Kjo tabelë rezultatesh është e falsifikuar. Rezultati real është i pasqyruar në tabelën e rezultateve që ne disponojmë, ku Ndre Legisi ka marrë 61 vota, ndërsa Kolin Gjoka ka marrë 137 vota. Për të vërtetuar këtë kërkojmë hapjen e kutisë së votimit. Për qendrën e votimit nr.1, rezultati është nxjerrë mbi bazën e një tabele rezultati që është firmosur vetëm nga tre anëtarë të komisionit, pra duke mos përmbushur "quorum"– in e nevojshëm për marrjen e vendimit. Duke mos patur një rezultat të legjitimuar për këtë qendër votimi kërkojmë shpalljen e pavlefshëm të rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, kërkuesit dhe përfaqësuesit e tyre, subjektet e interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.172, datë 13.7.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore nr.14; të shpallen të pavlefshme zgjedhjet në qendrat e votimit nr.12 e 13 të Komunës Fan të Zonës Zgjedhore nr.14 dhe përsëritjen e zgjedhjeve në këto qendra votimi më datën 22 korrik 2001.

Kërkuesi Ndre Legisi, duke qenë pjesërisht dakord me vendimin e mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar anullimin e këtij vendimi përsa i përket përsëritjes së zgjedhjeve në qendrën e votimit nr.12 të Komunës Fan. Në vijim kërkuesi ka pretenduar se në këtë qendër votimi procesi i votimit është realizuar konform Kodit Zgjedhor e për pasojë edhe rezultati i dalë është i ligjshëm.

Ndryshe sa pretendon kërkuesi, në përfundim të gjykimit në Gjykatën Kushtetuese rezultoi se, mbas mbylljes së qendrës së votimit nr.12 më datë 8.7.2001 në raundin e dytë të zgjedhjeve, ka filluar numërimi i fletëvotimeve. Në momentin kur po numëroheshin fletëvotimet që u vlerësuan si të pavlefshme, anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit nuk janë marrë vesh lidhur me këtë shifër dhe për këtë kanë shkuar të sqarohen në Komisionin e Zonës Zgjedhore në qytetin e Rrëshenit. Edhe me ndihmën e Komisionit të Zonës Zgjedhore nuk është nxjerrë rezultati. Për këtë është njoftuar edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Gjatë gjykimit, rezultoi se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, lidhur me qendrën e votimit nr.12, ka arsyetuar se kutitë e votimit kanë ardhur në Komisionin e Zonës Zgjedhore të hapura. Nga ana e tij, kërkuesi nuk solli prova për të provuar të kundërtën, ndërkohë që si kërkues barra e provës i takon atij. Prandaj, me të drejtë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve edhe në këtë qendër votimi.

Nga ana e tij edhe kërkuesi Kolin Gjoka, përveç qendrës së votimit të mësipërme, ka kërkuar përsëritjen e zgjedhjeve edhe në qendrën e votimit nr.1 fshati Kalur, Komuna Kashnjet dhe në qendrën e votimit nr.3 fshati Kushnen, Komuna Kaçinar. Lidhur me qendrën e votimit nr.1, kërkuesi ka pretenduar se rezultati i nxjerrë për këtë qendër votimi është i pavlefshëm, sepse tabela e rezultateve është nënshkruar nga tre anëtarë të Komisionit të Qendrës së Votimit, pra pa u formuar "quorum" – i nevojshëm për marrjen e vendimit. Në kundërshtim me sa pretendon kërkuesi, në përfundim të gjykimit rezultoi se tabela e rezultatit për qendrën e votimit nr.1 është hartuar e nënshkruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor, duke u formuar edhe shumica e nevojshme për marrjen e një vendimi të vlefshëm.

Lidhur me qendrën e votimit nr.3, kërkuesi pretendoi se tabela e rezultatit model 54 e hartuar

nga komisioni i kësaj qendre votimi është i falsifikuar. Për këtë, kërkuesi paraqiti në Gjykatën Kushtetuese një fotokopje të një tabele rezultatesh, që, sipas tij, ishte fotokopje e tabelës origjinale. Nga ana e tij, lidhur me këtë qendër votimi, kërkuesi Ndre Legisi ka paraqitur në gjyq tabelën origjinale model 54, që duke u rakorduar edhe me tabelat model 39 e 39/1 të Komisionit të Zonës Zgjedhore, del se është marrë për bazë në nxjerrjen e rezultatit për këtë qendër votimi. Në këto kushte, kërkuesi Kolin Gjoka me anën e tabelave – fotokopje nuk mund të provojë falsitetin e dokumenteve të qendrës së votimit të përpiluara në mënyrë të rregullt.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se të dyja kërkesat janë të pabazuara e si të tilla duhet të rrëzohen.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës; nenit 141 të Kodit Zgjedhor si dhe neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.88, datë 10.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 10.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.85 Akti që i përket:

KËRKUES: MERO BAZE, kandidat për deputet i subjektit elektoral "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar me prokurë nga avokat Kreshnik Spahiu.

SUBJEKTE TE INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. GAZMIR BIZHGA, përfaqësuar me deklarim nga avokat Nikolla Kondakçi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.010, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Për shfuqizimin e vendimit të mësipërm kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

Nga ana e Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.26 e më pas nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk janë marrë në konsideratë ankesat e Komisioneve të Qendrave të Votimit për shkeljet e rënda gjatë procesit zgjedhor. Në qendrën e votimit nr.4, kutia e votimit është mbushur nga policia; në qendrën e votimit nr.8, anëtarët e komisionit kanë pajisur një person me disa fletë votimi; në qendrën e

votimit nr.14, një votues votoi për gjithë familjen; në qendrat e votimit nr.3, 6, 7, 11, 11/1, 12, 71, 78 dhe 78/1, procesverbalet janë plotësuar pas dëbimit të komisionerëve të opozitës; në qendrat e votimit nr.66/1, 72 e 77, Komisioni i Zonës Zgjedhore nuk ka emëruar tre nënkryetarë të këtyre komisioneve; në qendrën e votimit nr.71, komisionerët e pozitës kanë ndikuar në mënyrë të hapur tek zgjedhësit; në procesin e numërimit të votave, komisionerët e opozitës janë nxjerrë jashtë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, subjektet e interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.010, datë 30.6.2001 ka vendosur të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.26, duke njohur si fitues kandidatin për deputet të Partisë Socialiste të Shqipërisë zotin Gazmir Bizhga.

Kërkuesi Mero Baze ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke pretenduar një sërë shkeljesh, të tilla si: nuk janë emëruar nënkryetarët e komisioneve në disa qendra votimi; në qendrën e votimit nr.4 kutia e votimit është mbushur nga policia; në qendrën e votimit nr.8 anëtarët e komisionit kanë pajisur një person me disa fletë votimi; në qendrën e votimit nr.14 një votues votoi për gjithë familjen; në qendrën e votimit 71 komisionerët e pozitës kanë ndikuar në mënyrë të hapur tek zgjedhësit; në disa qendra votimi procesverbalet janë plotësuar pas dëbimit të komisionerëve të opozitës.

Lidhur me pretendimin se Komisioni i Zonës Zgjedhore nuk ka caktuar nënkryetarë në disa qendra votimi Gjykata Kushtetuese vlerëson se kjo është një çështje që i përket periudhës parazgjedhore. Në këtë fazë, çdo pretendim zgjidhet në rrugën e ankimit që parashikon neni 140/1 i Kodit Zgjedhor.

Përsa i përket pretendimit se në qendrat e votimit nr.4 dhe nr.8 janë futur në kutinë e votimit disa fletë votimi nga një votues, rezultoi se kjo parregullsi nuk ka ndikuar në rezultatin e votimit për këto qendra votimi. Konkretisht, pas ndërhyrjes së komisionit, këto fletë votimi nuk janë llogaritur në nxjerrjen e rezultatit. Pas këtyre rasteve votimi ka vazhduar normalisht.

Po kështu, edhe pretendimet se ka patur persona që kanë votuar për gjithë familjen, se janë vjedhur fletë votimi, janë të pabazuara. Në këtë drejtim, në procesverbalet dhe në tabelat e rezultateve të qendrave të votimit nuk janë pasqyruar vërejtje që lidhen me shkeljet e pretenduara. Tabelat e rezultateve dhe procesverbalet janë dokumentet që pasqyrojnë gjithë momentet e procesit të votimit dhe përderisa në to nuk janë pasqyruar shkeljet e mësipërme, atëhere pretendimet e mësipërme nuk mund të merren si të provuara.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuesit Mero Baze duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës; nenit 140 të Kodit Zgjedhor si dhe neneve 26 e 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.89, datë 14.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.95 Akti që i përket:

KËRKUESE: MIMOZA AHMETI, kandidate për deputete e koalicionit "Bashkimi për Fitore" në zonën zgjedhore nr.43.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.

2. MONIKA KRYEMADHI, kandidate për deputete e Partisë Socialiste, përfaqësuar me prokurë nga avokat Agim Muça.

3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.43, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.944, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kërkuesja ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Vendimi i Gjykatës së Apelit të Tiranës nr.72, datë 22.6.2001 është i paligjshëm dhe antikushtetues, sepse ajo Gjykatë nuk ka të drejtë të anulojë vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të mënjanojë gjykimin në gjykatën e shkallës së parë.
- Më është mohuar e drejta e ankimit të vendimit të gjykatës së apelit.
- Gjatë procesit të rishikimit të listave të zgjedhësve, u evidentuan një numër i madh prej tyre të regjistruar në dy lista zgjedhësish, si dhe zgjedhës të paregjistruar fare.
- Gjatë punës në Komisionin e Zonës Zgjedhore, është zhdukur nga sekretarja Fletorja e Protokollit të Mbledhjeve të Komisionit.
- Janë shkelur haptazi normat e Kodit Zgjedhor për mënyrën e shpalljes së rezultatit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuesen, subjektet e interesuara, administroi provat dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.43 Tiranë, në bazë të procesverbaleve të ardhura nga komisionet e qendrave të votimit, ka shpallur deputete të drejtpërdrejtë zonjën Monika Kryemadhi me vendimin nr.007, datë 25.6.2001. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuesja Mimoza Ahmeti në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe ky i fundit, me vendimin nr.944, datë 28.6.2001, ka shpallur rezultatin përfundimtar të asaj zone, duke njohur si fituese kandidaten e shpallur nga Komisioni i Zonës Zgjedhore. Të dy këto vendime harmonizohen me përmbajtjen e tabelave të rezultateve të nxjerra nga komisionet e qendrave të votimit të nënshkruara rregullisht nga anëtarët e komisioneve.

Kërkuesja nuk paraqiti prova për të vërtetuar se janë shkelur rregullat e parashikuara në nenin 107 të Kodit Zgjedhor për hapjen e kutive të votimit e për verifikimin në to të vulave, procesverbaleve

origjinale, fletëvotimeve, etj. Përkundrazi, edhe komisionerët e propozuar nga partitë e koalicionit "Bashkimi për Fitore", nuk kanë bërë vërejtje të tilla në procesverbalet përkatëse dhe mbi të gjitha vetë kërkuesja nuk pretendoi që procesverbalet origjinale të ndodhura në kuti të kenë të dhëna të ndryshme nga procesverbalet e marra prej saj.

Pretendimet e tjera të kërkueses për ndryshimin e përbërjes së komisioneve me vendim të paligjshëm e antikushtetues të Gjykatës së Apelit apo për zhdukjen e fletores së protokollit nga sekretarja nuk provuan të kenë sjellë ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin e votimit. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, Gjykata e Apelit, sipas nenit 142 të Kodit Zgjedhor, është kompetente për të shqyrtuar ankimet kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo Gjykatë, pasi shqyrtoi çështjen, vendosi shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilin ishte pranuar lista emërore e komisionerëve të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, të paraqitur nga partia në qendër, duke konsideruar si të vlefshme listën e komisionerëve të paraqitur nga dega e partisë për Tiranën.

Përsa i përket mangësive e parregullsive në listat e zgjedhësve jo vetëm që nuk mund të nxirret konkluzion për ndikimin e tyre në fitoren apo humbjen e çdo kandidati, por, sipas nenit 143 të Kodit Zgjedhor, çdo zgjedhës që nuk është regjistruar në listat e zgjedhësve mund të ankohet në gjykatën e rrethit, jo më vonë se 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Në këtë mënyrë, ishin të gjitha mundësitë që të mos i cenohej askujt e drejta e zgjedhjes.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/e të Kushtetutës; nenit 140 të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.90, datë 25.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 29.5.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30 Akti që i përket:

KëRKUES: Beglije Minarolli; Kudrete Hysa; Murat Petrela; Enver e Agim Preza; Gazmend,Mustafa e Ormir Fortuzi; Vjollca Velja, përfaqësuar nga avokate Liljana Ruli, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Muhamer, Ahmet e Kadri Pazari; Zana Shima; Nermin Luzi; Zeqine Çaçi; Ndriçim, Donika e Engjell Kazazi; Fatbardha Rama, përfaqësuar nga avokati Dashamir Kore me prokurë.

Komisioni i kthimit dhe kompensimit të pronave Tiranë, në mungesë.

O B J E K T I:

1. Shpallja si antikushtetuese e vendimeve nr.1319, datë 12.3.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.1515, datë 11.6.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.1303, datë 7.11.1997 të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.B-15, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

2. Shpallja si antikushtetuese e vendimeve të dhëna mbi kërkesën për rishikim nr.67, datë 18.12.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.843, datë 6.5.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1478, datë 3.12.1998 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të përmendura në objekt:

I. Argumentet për proces të parregullt:

1. Gjykatat janë mbështetur në vendimin nr.464, datë 13.8.1948 të Komitetit Ekzekutiv të qytetit të Tiranës për sekuestrim të pasurisë së Sheh Ali Pazarit, por nga ky akt del se prona nuk ka qenë e regjistruar në hipotekë në emër të tij. Po ashtu, Komisioni dhe gjykatat janë mbështetur në vendimin nr.233, datë 24.1.1994 të gjykatës së rrethit për vërtetim të faktit të pronësisë, por ky vendim është prishur nga Gjykata e Kasacionit. Në këto kushte, a mund të quhet procesi gjyqësor i rregullt?

2. Komisioni ka disponuar dy herë mbi të njëjtën pasuri duke njohur pronar Teqen Halvetiane dhe më pas Ali Pazarin. Gjykata refuzon kërkesën për të thirrur si palë Teqen Halvetiane.

3. Gjykata ka mbajtur qëndrim të njëanshëm, duke refuzuar kërkesën për ekspertim të vendimit nr.518, datë 2.2.1939 të Gjykatës së Paqit Tiranë. Duke qenë një provë vendimtare e dyshimtë, ekspertimi ishte i domosdoshëm për një proces të rregullt gjyqësor.

4. Në seancë është paraqitur ekzemplari origjinal i këtij vendimi nga pala e paditur, por ky vendim është kthyer pa të drejtë, në vend që të administrohej si provë dhe të përdorej si objekt ekspertimi. Më vonë, me kërkesë të prokurorisë është bërë ekspertimi me grup ekspertësh, të cilët konkludojnë se ky vendim është i falsifikuar.

5. Gjykatat nuk kanë zhvilluar hetim të plotë e të gjithanshëm, por kanë njohur si trashëgimtar të vetëm testamentar Sheh Ali Pazarin, pa u paraqitur si provë testamenti dhe pa u sqaruar nëse prekej rezerva ligjore.

6. Kemi vërtetuar prejardhjen e pasurisë objekt padie që nga viti 1917; për këtë kemi paraqitur dokumentet përkatëse.

7. Pasuria në pronësi të Ahmet Pazarit nuk është transkriptuar asnjëherë në hipotekë apo kadastër në emër të djalit të tij Ali Pazari. Gjykata ka injoruar të gjitha provat që janë paraqitur për këtë.

8. Gjykata, pa iu referuar ndonjë dispozite ligjore, lë të kuptohet se Ali Pazari ka fituar pronësinë me parashkrim, gjë që vjen në kundërshtim me Kodin Civil të asaj kohe.

II. Argumentet për shkelje të të drejtave kushtetuese në rishikim

1. Dosja gjyqësore e marrë në Arkivin e Shtetit përbënte një rrethanë të re me rëndësi vendimtare, por gjykata arsyeton se nuk përbën provë të re, pa treguar përse nuk ndikon në zgjidhjen e çështjes.

2. Vetëm nga numri dhe data e vendimit krijohet dyshimi se jemi para një anomalie, sepse nuk janë dhënë 518 vendime në më pak se një muaj.

3. Gjykata nuk e ka pranuar rishikimin për shkak se sipas neneve 494/e e 495 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të jetë vërtetuar falsifikimi me vendim penal të formës së prerë. Ky është një qëndrim absurd sepse në rastet kur ndjekja penale nuk mund të fillojë çfarë do të bëhet?

4. Shprehja evazive, aspak profesionale se “vendimi nr.501, është një provë si gjithë të tjerat dhe nuk influencon në zgjidhjen e çështjes”, përbën thelbin e karakterit të kundërligjshëm të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe të shkeljes së të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjekteve të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me padinë në Gjykatën e Rrethit Tiranë, kërkuesit kanë kërkuar anullimin e vendimit nr.1104, datë 23.9.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili i kthente 651 m2 truall trashëgimtarëve të Sheh Ali Pazarit, me pretendimin se kjo pronë ka qenë e gjyshit Sheh Ahmet Pazari.

Gjithashtu, është kërkuar anullimi i dy vendimeve të tjera për troje me sipërfaqe 1891 m2 dhe 1110 m2, sepse për ato Komisioni ishte shprehur një herë më parë.

Gjykata e rrethit me vendimin nr.1319, datë 12.3.1997, ka rrëzuar padinë me arsyetimin se prona është sekuestruar në vitin 1948 në emrin e Sheh Ali Pazarit, se nga dokumentet rezulton se pronar i vetëm është Ali Pazari dhe se sipas vendimit nr.518, datë 2.2.1939 të Gjykatës së Paqit Tiranë, del ekzistenca e testamentit dhe mbajtja e pasurisë nga Ali Pazari si trashëgimtar testamentar.

Vendimi i gjykatës së rrethit është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, ndërsa Gjykata e Kasacionit dhe Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë vendosur mospranimin e rekurseve.

Kërkuesit kanë përdorur edhe mundësinë tjetër ligjore për rishikim të vendimit, por Gjykata e Rrethit Tiranë ka vendosur mospranimin e kërkesës me arsyetimin se vendimi i paraqitur nuk përbën provë të re shkresore që të ndikojë në zgjidhjen e çështjes. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Gjykata Kushtetuese, për çështje të kësaj natyre që kanë të bëjnë me kërkesa të individëve për shkelje të të drejtave kushtetuese, e përqëndron kontrollin e saj vetëm në respektimin e parimeve për të garantuar një proces të rregullt ligjor dhe nuk i hyn analizës së provave dhe zgjidhjes së çështjes në themel. Në këtë kuptim, pretendimet e kërkuesve nuk gjejnë mbështetje në nenet 42, 131 e 134 të Kushtetutës. Në tërësi, pretendimet e parashtruara nga kërkuesit dhe të paraqitura në tetë pikat e kërkesës, ngrenë probleme të analizës e çmuarjes së provave, të cilat kanë të bëjnë me kompetencën ekskluzive të gjykatave të zakonshme dhe që nuk mund të vlerësohen nga Gjykata Kushtetuese. Vlen të theksohet se mospranimi nga gjykata e kërkesave dhe pretendimeve të palëve nuk do të thotë se atyre u janë shkelur të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Përkundrazi, dëgjimi i pretendimeve të palëve dhe rrëzimi i tyre nga gjykata me vendim siç është vepruar në këtë rast, i shërben respektimit të të drejtave për një proces të rregullt ligjor. Prandaj, nuk mund të konsiderohet shkelje e parimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor mospranimi nga gjykatat për kryerje të ekspertimit të vendimit gjyqësor nr.518, datë 2.2.1939 të Gjykatës së Paqit Tiranë dhe as refuzimi për të thirrur Teqen Halvetiane si palë të tretë në gjykim. Ato vlerësohen në bazë të ligjit nga gjykatat e zakonshme, të cilat vendosin për pranimin ose refuzimin e kërkesave të tilla.

Gjykata nuk është e detyruar të pranojë apriori kërkesa të tilla, por pas dëgjimit të pretendimeve duhet që, në rast mospranimi, t'i refuzojë ato me vendim, ashtu siç është vepruar edhe me kërkuesit. Në këtë aspekt, kërkuesve nuk u është shkelur ndonjë e drejtë kushtetuese për proces të rregullt ligjor sepse pretendimet e tyre janë dëgjuar, shqyrtuar e refuzuar nga gjykata në bazë të ligjit.

Refuzimi i kërkesave që gjykata u ka bërë kërkuesve me vendim të ndërmjetëm, analiza dhe çmuarja e provave të administruara dhe dhënia e vendimeve mbi bazën e tyre nuk kanë të bëjnë me shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Edhe përsa i përket pjesës tjetër të kërkesës, që ka të bëjë me shfuqizimin e vendimeve të rishikimit, në të nuk evidentohen shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe as përmendet qoftë edhe ndonjë shkelje e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Sipas shkronjës "a" të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të jenë zbuluar rrethana apo prova të reja të cilat nuk mund të diheshin nga pala dhe jo prova shkresore që janë administruar në gjykim siç ka ndodhur në rastin konkret. Lidhur me pretendimin tjetër që gjykatat kanë gabuar që nuk kanë pranuar se vendimi nr.518, datë 2.2.1939 është i falsifikuar e për rrjedhojë duhej të pranohej kërkesa e rishikimit, çmohet se nuk ka mbështetje ligjore, prandaj me të drejtë është rrëzuar nga gjykata. Kjo për faktin se, sipas nenit 495 të Kodit të Procedurës Civile, "rishikimi i vendimeve për rrethanat e parashikuara në shkronjat "b, c dhe ç" të nenit 494 të këtij Kodi lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë".

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesit nuk vërteton që atyre t'u jenë shkelur të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 e 134 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.91, datë 12.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Gjergj Sauli,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço,	Anëtar i ""
Kujtim Puto,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Tefta Zaka,	Anëtare e ""
Sokol Sadushi,	Anëtar i ""
Petrit Plloçi,	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 5.7.2001 dhe 12.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.74 Akti që i përket:

KËRKUES: GAFURR MUKA, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.19 i subjektit elektoral "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar me prokurë nga avokat Neshat Fana.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.

2. ISMAIL LLESHI, përfaqësuar me prokurë nga avokat Baftjar Rusi.

O B J E K T I:

Shfuqizimin e vendimit nr.006, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

BAZA LIGJORE: Nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Vendimi është i pambështetur si në ligj ashtu edhe në prova.
- Janë marrë për bazë, në mënyrë të njëanshme vetëm procesverbalet që ne i kontestojmë si të falsifikuar.
- Për qendrat e votimit nr.6 Radovesh e nr.10 Lejçan, procesverbalet origjinale e të formosura rregullisht nuk janë marrë për bazë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.006, datë 29.6.2001, ka vendosur të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.19, duke njohur si fitues kandidatin e pavarur për deputet zotin Ismail Lleshi.

Kërkuesi Gafurr Muka, kandidat për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore", me kërkesën e paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe urdhërimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.19.

Në kërkesë dhe në gjykim kërkuesi ka pretenduar se Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.19, në nxjerrjen e rezultatit për qendrën e votimit nr.6, ka marrë për bazë një tabelë rezultati që nuk pasqyron të vërtetën. Ky komision, sipas kërkuesit, duhet të merrte për bazë tabelën model 54 që ka paraqitur ky i fundit. Në këtë drejtim, për verifikimin e këtij pretendimi Gjykata krahasoi tabelën model 54 të paraqitur nga kërkuesi, si dhe tabelën model 54 të paraqitur nga i interesuari, nga ku rezultoi se të dyja këto tabela janë të firmosura nga të njëjtët komisionerë, por kanë rezultate të ndryshme. Kështu, në tabelën model 54, të paraqitur nga kërkuesi Gafurr Muka rezultojnë të jenë shënuar 67 fletëvotimi të vlefshme në favor të kërkuesit dhe 52 fletëvotimi të vlefshme në favor të të interesuarit; ndërsa në tabelën e rezultatit model 54, që është marrë për bazë në nxjerrjen e rezultatit nga Komisioni i Zonës Zgjedhore një kopje e së cilës është paraqitur edhe nga i interesuari, janë pasqyruar 18 fletëvotimi të vlefshme për kërkuesin dhe dhe 134 fletëvotimi të vlefshme për të interesuarin.

Meqenëse gjykatës nuk iu paraqitën argumente bindëse pse Komisioni i Zonës Zgjedhore në nxjerrjen e rezultatit kishte marrë për bazë tabelën e rezultatit model 54 të paraqitur nga i interesuari, atëhere iu kërkua si kërkuesit, ashtu edhe të interesuarit të paraqisnin për krahasim edhe dokumente të tjera si tabela rezultatesh model 54 që u janë dhënë subjekteve të tjera që kanë patur përfaqësuesit e tyre në qendrën e votimit nr.6. Mirëpo, këto tabela rezultatesh, të cilat nëqoftëse mbështesnin njërën apo tjetrën palë do të kishin rëndësi për çështjen, nuk u paraqitën.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vendosi të hapë kutinë e votimit të qendrës së votimit nr.6 të zonës zgjedhore nr.19, për të bërë numërimin e votave. Nga numërimi rezultuan për kërkuesin 20 fletëvotimi të vlefshme, për të interesuarin 136 fletëvotimi të vlefshme, ndërsa fletë votimi të pavlefshme 42. Për kandidatët e tjerë, N.Marku 1 fletëvotimi e vlefshme dhe S.Zhulalin 1 fletë votimi e vlefshme.

Në këto rrethana, meqenëse numri i fletëvotimeve të vlefshme për secilën palë që u gjetën prej Gjykatës Kushtetuese në kutinë e votimit të qendrës së votimit nr.6 mbështet rezultatin e Komisionin të Zonës Zgjedhore, atëhere konkludohet që kërkesa e kërkuesit Gafurr Muka duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, neneve 113 e 141 të Kodit Zgjedhor, si dhe në nenet 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.92, datë 20.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“
Alfred Karamuco,	Anëtar i	“
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“
Kujtim Puto,	Anëtar i	“
Petrit Plloçi,	Anëtar i	“
Tefta Zaka,	Anëtare e	“
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 18.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.103 Akti që i përket:

KËRKUES: SHPËTIM KATESHI, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokat Ilir Panda.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. HALIT SHAMATA, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore”, përfaqësuar me prokurë nga Vladimir Mulaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.170, datë 13.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kërkuesi, për shfuqizimin e vendimit nr.170, datë 13.07.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i paargumentuar dhe i mbështetur në provat e domosdoshme për marrjen e një vendimi.
- Për tre qendra votimi, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vetëm sa përmend faktin e pjesmarrjes në votim të zgjedhësve në masën 100 % dhe 101 %, por nuk jep asnjë argument, përveç deklarimit të anëtarëve të Komisionit të Zonës Zgjedhore, pa shpjeguar konkretisht se të cilit anëtar.
- Në të gjitha qendrat e votimit, me përjashtim të 19 qendrave që nuk është zhvilluar votimi, procesverbalet janë të nënshkruara nga të gjithë komisionerët dhe pa asnjë vërejtje nga ata ose përfaqësuesit e tyre.
- Argumenti që jep Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vendimin e tij “… se në disa qendra votimi kutitë kanë rezultuar të hapura”, nuk gjen mbështetje në asnjë provë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit, subjektet e interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në datën 8.7.2001, në zonën zgjedhore nr.49 është zhvilluar raundi i dytë i zgjedhjeve ndërmjet kandidatit për deputet të Partisë Socialiste Shpëtim Kateshi dhe kandidatit për deputet të koalicionit “Bashkimi për Fitore” Halit Shamata. Në përfundim të votimit, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.49 ka nxjerrë rezultatin për 38 qendra votimi, ndërsa për 19 qendra votimi të Komunës Pajovë dhe të Bashkisë Peqin që përfshihen në këtë zonë ka konkluduar se votimi nuk është zhvilluar.

Kandidati për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore” Halit Shamata ka ushtruar ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në të gjithë zonën, duke ngritur pretendime lidhur me pengimin që u është bërë përfaqësuesve të subjektit që ai përfaqëson për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për ushtrimin e dhunës policore në qendrat e votimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.170, datë 13.7.2001, ka vendosur të shpallë të pavlefshme zgjedhjet për Kuvendin në Zonën Zgjedhore n.49 dhe zhvillimin e votimeve më datën 22 Korrik 2001.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve arsyeton në vendimin e tij se janë vërejtur shkelje të ligjit, të cilat kanë ndikuar në devijimin e rezultatit të zgjedhjeve në këtë zonë. Në këtë vendim përmenden si argumenta për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, pjesëmarrja e zgjedhësve në një qendër votimi në raport me rezultatin e nxjerrë në masën 101% dhe në dy qendra të tjera në masën 100% si dhe fakti se në disa qendra votimi kutitë kanë rezultuar të hapura.

Objekti i shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, në kuptim të nenit 113 të Kodit Zgjedhor, është bazueshmëria ose jo në ligj e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka shpallur pavlefshmërinë. Nga shqyrtimi që i bëri Gjykata Kushtetuese të gjithë dokumentacionit përkatës, i cili ka shërbyer për marrjen e vendimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, rezulton e provuar se në 19 qendra votimi të Komunës së Pajovës dhe të Bashkisë së Peqinit votimet nuk janë zhvilluar. Gjithashtu vërtetohet se në qendrat e votimit nr.11, 12 të Komunës Karinë dhe në qendrën e votimit nr.34 të Komunës Përparim, pjesmarrja e zgjedhësve në votime ka rezultuar në masën 100% dhe 101 %, fakt i cili ka qenë i mjaftueshëm për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të vendosur pavlefshmërinë e zgjedhjeve për këto qendra votimi.

Për të gjitha qendrat e tjera të votimit, Gjykata Kushtetuese konkludon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka arritur në përfundimin për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendrat e tjera të votimit, vetëm mbi bazën e opinioneve dhe pa administruar asnjë provë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ kushtetues, por veprimtaria që ai kryen në raste të tilla është e aspektit administrativ dhe procedura që ai ndjek mbështetet në rregullat e përgjithshme procedurale që parashikon Kodi Zgjedhor, si dhe Kodi i Procedurave Administrative.

Kandidati për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore”, Halit Shamata, kur ka paraqitur ankimin administrativ në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kishte edhe detyrimin ligjor për të provuar të gjitha pretendimet e parashtruara, të cilat lidhen me dhunën policore të ushtruar gjatë procesit zgjedhor apo për pengesat që u janë krijuar përfaqësuesve të subjektit të tij zgjedhor për të qenë të pranishëm në zgjedhje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili ndodhet i administruar në dosjen gjyqësore, nuk rezulton e provuar me asnjë provë prezenca e dhunës policore në këtë zonë apo fakti se kutitë e votimit kanë qenë të hapura. Kjo është e mjaftueshme për Gjykatën Kushtetuese për të konkluduar se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është pjesërisht i pabazuar në ligj.

Kërkuesi paraqiti para Gjykatës Kushtetuese procesverbalet model 54 të mbajtura nga komisionet e qendrave të votimit, për të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte vendosur pavlefshmërinë e zgjedhjeve, nga ku rezulton se të gjithë anëtarët e komisioneve, ku përfshihen edhe komisionerët e koalicionit “Bashkimi për Fitore” i kanë nënshkruar ato pa asnjë vërejtje.

Në këto kushte, në kuptim dhe të neneve 246 e vijuese të Kodit të Procedurës Civile, dispozitat e të cilit janë të zbatueshme për këto lloj gjykimesh, aktet zyrtare përbëjnë provë të plotë për përmbajtjen, për sa kohë nuk vërtetohet falsiteti i tyre. Të gjitha procesverbalet e qendrave të votimit, të cilat rezultojnë të rregullta, nuk janë marrë parasysh nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjë që ka sjellë padrejtësisht shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të gjithë zonën.

Kandidati për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore” Halit Shamata paraqiti në gjykatë të njëjtat pretendime që kishte paraqitur edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me dhunën policore, duke arsyetuar se këtë e provonte edhe me një kasetë filmike të cilën pretendoi se e posedonte, por që nuk e paraqiti në gjykatë për ta administruar si provë.

Të vetmet prova shkresore që ai paraqiti, mbi të cilat Gjykata Kushtetuese konkludoi për pranimin e pretendimit të tij si të drejtë dhe për mosprekje të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në atë pjesë, lidhen me pjesmarrjen në disa komisione të qendrave të votimit të personave të paemëruar si anëtarë. Kështu në qendrat e votimit nr.14, 15, 16, 19 të Komunës Gjocaj, si dhe në qendrat e votimit nr.32, 36 të Komunës Përparim rezulton se kanë nënshkruar procesverbalet model 54

persona të paemëruar nga Komisioni i Zonës Zgjedhore si anëtarë komisioni, duke shkelur në këtë mënyrë nenet 35 pika 4, 43 e 45 të Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu në dosjen gjyqësore nuk ndodhet e administruar asnjë provë shkresore që të vërtetojë pretendimin tjetër të kandidatit për deputet Halit Shamata, lidhur me pengesat që u janë krijuar përfaqësuesve të subjektit të tij zgjedhor për të marrë pjesë në zgjedhje. Një pretendim i tillë nuk vërtetohet të ketë gjetur pasqyrim as në vendimin apo dokumentacionin që është mbajtur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Nga të gjitha provat e administruara për Gjykatën Kushtetuese rezulton e provuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pa analizuar provat e paraqitura dhe duke mos i vlerësuar drejt ato, ka konkluduar në shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të gjithë zonën, ndërkohë që nga provat rezulton e provuar se zgjedhjet duhet të përsëriten vetëm në 19 qendra votimi ku nuk janë zhvilluar votimet, si dhe në tre qendrat ku pjesëmarrja është mbi 100%.

Nga provat e paraqitura nga kandidati për deputet Halit Shamata në seancë gjyqësore, Gjykata Kushtetuese çmon se edhe për 6 qendra votimi, ku si anëtar komisioni kanë marrë pjesë persona të paemëruar si të tillë, zgjedhjet janë të pavlefshme dhe me të drejtë është vendosur përsëritja e tyre.

Nga sa më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa duhet pranuar pjesërisht, duke e shfuqizuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në atë pjesë dhe për ato qendra votimi që nuk vërtetohet me asnjë provë se zgjedhjet kanë qenë të pavlefshme, duke e lënë në fuqi vendimin për pavlefshmërinë e zgjedhjeve për pjesën tjetër.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja "e" dhe 132 të Kushtetutës, në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe në nenin 113 pika 5 të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr.170, datë 13.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe zhvillimin e raundit të dytë në qendrat e votimit nr.11, 12 të Komunës Karinë; në qendrat e votimit nr.14, 15, 16, 19 të Komunës Gjocaj; në qendrat e votimit nr.32, 34, 36 të Komunës Përparim, si dhe në 19 qendrat e votimit të Komunës Pajovë e të Bashkisë Peqin, ku nuk është zhvilluar votimi.

V E N D I M
Nr.94, datë 26.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 24.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.105 Akti që i përket:

KËRKUES: ALFRED OLLI, kandidat për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar nga avokat Arben Ristani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. RAHMI MEHMETLLARI, kandidat për deputet i Partisë Socialiste,
3. KOMISIONI I ZONES ZGJEDHORE NR.82, përfaqësuar nga Pëllumb Kulla.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.183, datë 19.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.82 dhe të vendimit nr.13, datë 15.7.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore, ose konstatimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendrat e votimit nr.16, 17, 30, 32, 33, 34, 35 dhe 36 të zonës zgjedhore nr.82

BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, subjektet e interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.82, me vendimin nr.13, datë 15.7.2001, pas rinumërimit të votave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, shpalli deputet të drejtpërdrejtë të kësaj zone kandidatin e Partisë Socialiste, Rahmi Mehmetllarin, i cili fitoi gjithsej 7 021 vota me një diferencë prej 169 votash më shumë se kandidati i koalicionit "Bashkimi për Fitore" Alfred Olli, që fitoi 6852 vota. Rahmi Mehmetllari u njoh fitues edhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.183, datë 19.7.2001 të shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Kërkuesi Alfred Olli, me kërkesën paraqitur Gjykatës Kushtetuese, parashtroi se shpallja deputet e Rahmi Mehmetllarit është e paligjshme sepse prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, gjatë rinumërimit të fletëvotimeve janë lejuar shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor. Sipas kërkuesit, këto shkelje konsistojnë në faktin se:

1. Në kutitë e qendrave të votimit nr.34, 35 dhe 36 u gjetën fletëvotimi të vulosura jo me vulën e tyre, por me një vulë tjetër dhe gjatë rinumërimit gjykata nuk pranoi t'i konstatojë e vlerësojë ato si të tilla.
2. Në kutitë e qendrave të votimit nr.17 e 30 u panë mospërputhje midis numrit të fletëvotimeve të marra në dorëzim dhe numrit të fletëve të gjetura në kuti.
3. Në kutitë e qendrave të votimit nr.34, 35 dhe 36 numri i fletëvotimeve të gjetura në kuti ishte më i madh se numri i votuesve të pasqyruar në listat e zgjedhësve.
4. Në kutinë e qendrës së votimit nr.16 shumë fletëvotime nuk ishin nënshkruar nga kryetari i kësaj qendre, por nga një person i paidentifikuar.

Kërkuesi pretendoi gjithashtu se edhe për shkeljet e përmendura më sipër në pikat 2, 3 dhe 4, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë gjatë rinumërimit nuk kishte pranuar të bënte konstatimin e këtyre shkeljeve si dhe numërimin dhe vlerësimin e fletëvotimeve që kishin lidhje me to.

Pretendimet e kërkuesit u provuan gjatë gjykimit me vendimet e ndërmjetme që ka marrë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë në datën 12.7.2001, me procesverbalin e mbajtur prej saj për rinumërimin e fletëvotimeve të qendrave të votimit të zonës zgjedhore nr.82 dhe me vërejtjet e parashtruara me shkrim në datën 15.7.2001 nga komisionerët e Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.82 Eduart Malelli, Rexhep Xhihani e Pullumb Kulla.

Vendimet e ndërmjetme të gjykatës dhe aktet e tjera të nxjerra prej saj gjatë rinumërimit të votave në qendrat e mësipërme të votimit vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Vendimet e ndërmjetme të gjykatës dhe aktet e tjera të nxjerra prej saj gjatë procesit të

rinumërimit të votave në qendrat e mësipërme të votimit tregojnë se kjo gjykatë nuk ka ushtruar në këtë proces të gjitha kompetencat ligjore të përcaktuara në dispozitat e Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, rezultoi qartë se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë është zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor, fakt ky që lejon Gjykatën Kushtetuese të shqyrtojë çështjen objekt gjykimi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, padrejtësisht, e ka quajtur identifikimin e vulës në fletë votimet si një çështje që nuk i përket kompetencës së saj në procesin e rinumërimit të fletëvotimeve. Kjo për faktin se, në bazë të nenit 110 pika 3 shkronja "d" të Kodit Zgjedhor, gjykata është e detyruar që të kontrollojë nëse fletëvotimi është i vulosur sipas nenit 88 të këtij Kodi, pra nëse është e vërtetë kjo vulë apo jo, sepse kjo çështje ka të bëjë me vlefshmërinë e fletëvotimit parashikuar në nenin 106 pika 3 të Kodit Zgjedhor. Veç kësaj, Gjykata, sipas pikës 3 shkronjat "d, dh", gjatë rinumërimit ushtron kompetencat e Komisionit të Qendrës së Votimit dhe se për çdo fletëvotimi të kundërshtuar ajo duhet të marrë vendim të arsyetuar, duke mbajtur shënim në procesverbalin e rinumërimit gjë që nuk është bërë në çështjen në shqyrtim.

Gjykata ka mbajtur një qëndrim të gabuar edhe në lidhje me çështjen e mospërputhjes së fletëvotimeve të gjetura në kuti me fletët e marra në dorëzim ose të fletëvotimit të gjetura në kuti me numrin e votuesve në lista etj.

Kështu kjo gjykatë, me vendimin e saj të ndërmjetëm të datës 12.7.2001, shprehet se në rinumërim nuk është detyrë e saj që të shikojë listat e votuesve ose fletëvotimet të papërdorura. Ky qëndrim i gjykatës është shprehje e keqinterpretimit të ligjit dhe përbën një shmangje tjetër nga ushtrimi i detyrave të saj. Vendimet e mësipërme të gjykatës vijnë në kundërshtim me shkronjën "d" të pikës 3 të nenit 110 të Kodit Zgjedhor, në të cilën bëhet e qartë se "Gjatë rinumërimit gjykata ushtron kompetencat e Komisioneve të Qendrave të Votimit", që do të thotë se ajo është e detyruar të zbatojë edhe kërkesat e shkronjave "a,b" të pikës 1 të nenit 106 të Kodit Zgjedhor që bëjnë fjalë për listën e zgjedhësve që kanë votuar, për detyrimin e saj që të verifikojë edhe numrin e votuesve që kanë votuar sipas kësaj liste etj.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, gjatë rinumërimit të fletëve të votimit nuk ka kryer një proces të rregullt ligjor, prandaj konkludon që të bëhet përsëri rinumërimi i fletëve të votimit nga kjo gjykatë në gjashtë qendra votimi dhe konkretisht në ato me numër 16, 17, 30, 34, 35 dhe 36 të zonës zgjedhore nr.82.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja "e" dhe 132 të Kushtetutës, në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe në nenin 113 pika 5 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Të shpallë pjesërisht të pavlefshme vendimet nr.183, datë 19.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nr.13, datë 15.7.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.82.
- Të shpallë të pavlefshme aktet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për rinumërimin e fletëvotimeve në qendrat e votimit nr.16, 17, 30, 34, 35 dhe 36 të Zonës Zgjedhore nr.82.
- Të përsëritet rinumërimi i fletëvotimeve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë në qendrat e votimit nr.16, 17, 30, 34, 35 dhe 36 të Zonës Zgjedhore nr.82.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.95, datë 27.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Tefta Zaka,	Anëtare e	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.6.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.58 Akti që i përket:

KËRKUES: AGRON PRENDI, përfaqësuar nga avokat Shefqet Muçi.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHEM, përfaqësuar nga zoti Arqile Lole.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.4, datë 4.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; nr.32, datë 14.3.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.344, datë 5.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Në kërkesë janë parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

1. Të tri shkallët e gjykimit kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor sepse:

- Në kundërshtim me nenin 32/2 të Kushtetutës dhe me dispozitat përkatëse procedurale-penale (nenet 4, 153 – 154 të Kodit të Procedurës Penale) gjykatat i kanë mbështetur vendimet vetëm në mendime personale të disa personave të thirrur me cilësinë e dëshmitarëve;
- Dëshmitë e pranuara nga gjykatat si “indirekte” janë të pavlefshme e të papërdorshme;
- Në kundërshtim me sa pranohet nga gjykatat në çështjen konkrete nuk janë vërtetuar indicje në ngarkim të Agron Prendit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në datën 6.8.1997, në afërsi të fshatit Dedaj të rrethit të Pukës është gjetur i vrarë me armë zjarri viktima Rifat Istrefi. Në lidhje me këtë ngjarje, ka filluar procedimi penal ndaj kërkuesit Agron Prendi, i cili me vendimin nr.04, datë 4.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë është deklaruar fajtor për vrasje me dashje dhe armëmbajtje pa leje dhe, në bazë të neneve 76 e 278/II të Kodit Penal, është dënuar me 10 vjet heqje lirie. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.32, datë 14.3.2000 dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.344, datë 5.10.2000.

Nga shqyrtimi i pretendimeve të kërkuesit, si dhe çështjes në tërësi Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundim, se kërkesa duhet të rrëzohet me arsyetimin se në tërësi në të ngrihen shkaqe të cilat nuk kanë të bëjnë me realizimin e një procesi të rregullt gjyqësor në kuptim të neneve 42 e 131 të Kushtetutës e për pasojë nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe ajo e Apelit të Shkodrës kanë pyetur, me cilësinë e dëshmitarit, një numër personash, të cilët, edhe pse nuk ishin dëshmitarë okularë, kanë shpjeguar rrethana të ndryshme, të cilat janë vlerësuar nga gjykatat në lidhje me përcaktimin e fajësisë, motivet e kryerjes së krimit, si dhe shkallën e rrezikshmërisë së autorit. Në shqyrtimin e kësaj çështje nga këto gjykata, Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi që në marrjen e vlerësimin e thënieve të personave të jenë shkelur parimet themelore të një procesi të rregullt ligjor. Po kështu, mbledhja e të dhënave nuk del që të jetë bërë në rrugë e mënyra të paligjshme, çka do të vinte ndesh edhe me nenin

32 pika 2 të Kushtetutës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, ajo e Apelit Shkodër dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë thëniet e një numri personash të pyetur me cilësinë e dëshmitarit i kanë vlerësuar si burim provash e indicjesh, të cilat në tërësinë e tyre u kanë shërbyer për të krijuar bindje për çështjen konkrete dhe për vendimet e marra. Nëse ky vlerësim është ose jo i drejtë e i bazuar, kjo është çështje e vetë gjykatave dhe nuk mund të përbëjë objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët e mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por kurrsesi jo për mënyrën e vlerësimit të këtyre provave. Kjo për faktin se kontrolli kushtetues nuk mund të zëvëndësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete.

Në këto kushte kërkesa duhet të rrëzohet si e pa mbështetur në Kushtetutë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 e 132 të Kushtetutës, si dhe nenet 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.96, datë 27.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 30.5.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.32 Akti që i përket:

KËRKUES: QERIM MERJA, përfaqësuar nga avokat Përparim Sanxhaku, me prokurë.
SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.120, datë 03.03.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të sipërm:
1. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka rënduar pozitën e të pandehurit, pasi çështja në

gjykatën e apelit u shqyrtua mbi ankimin e të pandehurve dhe jo mbi ankimin e prokurorit.

2. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar një të drejtë të fituar në përputhje me ligjin. Ai cenon dukshëm të drejtën e të pandehurve në procesin penal, pasi fut pasigurinë për t'u ankuar.

3. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i padrejtë edhe për faktin se ai nuk ka bazë për ta marrë në shqyrtim këtë çështje, pasi nuk është asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit të Tiranës, me vendimin penal nr.779, datë 30.9.1998, ka deklaruar fajtor kërkuesin Qerim Merja për veprën penale të vjedhjes së pasurisë dhe, në bazë të neneve 134 e 48/ç të Kodit Penal, e ka dënuar me 13 muaj bugim. Po me këtë vendim është dënuar edhe vëllai i kërkuesit, i quajturi Petrit Merja, me 10 (dhjetë) vjet burgim për veprën penale të vjedhjes me armë e të armëmbajtjes pa leje, sipas neneve 140 e 278/2 të Kodit Penal.

Kundër këtij vendimi ka bërë apelim vetëm i gjykuari Petrit Merja dhe Gjykata e Apelit të Tiranës, me vendimin nr.336, datë 17.11.1998, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit me vërejtjen që ndryshimi i akuzës për kërkuesin Qerim Merja nga bashkëpunëtor në vjedhje me armë, sipas nenit 140 të Kodit Penal, në vjedhje të pasurisë sipas nenit 134 të Kodit Penal, është bërë në kundërshtim me provat. Vetë gjykata e apelit, duke zbatuar pikën 3 të nenit 425 të Kodit Penal, nuk mund t'i caktonte kërkuesit një dënim më të rëndë, sepse do të cenonte parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.

Kundër vendimeve të gjykatave të rrethit dhe të apelit ka ushtruar rekurs prokurori pranë Prokurorisë së Apelit të Tiranës. Ndryshe nga sa pretendohet në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në rekurs ngrihen probleme për ndryshimin e kualifikimit juridik të veprës penale, si dhe për zbatimin e rrethanave lehtësuese të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të Kodit Penal, si dhe mosrespektimin e tij. Prandaj, në kuptim të nenit 432/1 – a të Kodit të Procedurës Penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me të drejtë e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.120, datë 3.3.1999, ka lënë në fuqi vendimin nr.336, datë 17.11.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë për të gjykuarin tjetër Petrit Merja dhe e ka ndryshuar atë për kërkuesin për cilësimin ligjor nga vjedhje e pasurisë, sipas nenit 134 të Kodit Penal, në vjedhje me armë sipas nenit 140-25 të këtij Kodi, duke e dënuar nga 13 muaj në 12 vjet burgim.

Ndryshe nga sa pretendohet në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk cenon parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit dhe nuk ka të bëjë me të drejta të fituara.

Sipas nenit 43 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë. Është e vërtetë që me ankimin atij nuk mund t'i rëndohet pozita, por ky parim, pra mosrëndimi i pozitës, shërben si garanci kur mjetin e ankimit e ka përdorur i pandehuri dhe nuk mund të shërbejë si i tillë kur mjetin e ankimit e ka përdorur prokurori. Ky i fundit, në zbatim të detyrave kushtetuese, përfaqëson akuzën dhe i nënshtrohet Kushtetutës e ligjeve. Prandaj për rastet e shkeljeve ligjore nga gjykatat, të konkretizuara në një vendim të paligjshëm, prokuroria nuk mund të qëndrojë indiferente. Ajo ka detyrë të ushtrojë të gjitha mjetet procedurale për zbatimin e drejtë të ligjit. Atë që nuk mund ta bënte në rastin konkret gjykata e apelit për shkak të kufizimit procedural, të parashikuar në nenin 425 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale, e realizoi Gjykata e Lartë, e cila sipas nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale pranon rekurset kundër kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të apeleve e të rretheve dhe vendos për çështjet ligjore sipas neneve 434 e 441 të Kodit të Procedurës Penale.

PER KETO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.97, datë 27.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	""
Gjergj Sauli,	Anëtar i	""
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Tefta Zaka,	Anëtare e	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 1.6.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.29 Akti që i përket:

KËRKUES: Hysen, Betim Myshketa; Adile Dervishi; Dhurata Saraçi; Liri Dakoli, përfaqësuar nga avokatët Rifat Aliu e Luljeta Petani, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: KRISANTHI QIRKO, përfaqësuar nga avokat Rustem Syziu, me prokurë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.3186, datë 24.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Durrës; nr.1631, datë 22.3.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.1422, datë 8.10.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.N-18, datë 18.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Për të argumentuar kërkesën e tyre për antikushtetutshmëri të vendimeve gjyqësore të përmendura në objekt, kërkuesit parashtrojnë këto shkaqe:

1. Gjykatat kanë tejkaluar kompetencat e tyre, duke hyrë në kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Ato duhej ta pezullonin gjykimin dhe t'ia dërgonin çështjen Gjykatës Kushtetuese.

2. Pranimi i padisë nga gjykatat, duke arsyetuar se, me hyrjen në fuqi të dispozitave kryesore kushtetuese dhe të ligjit për kthimin e pronave, shfuqizohet çdo dispozitë ligjore e nënligjore apo vendim gjykate të dala pas datës 29 nëntor 1944, është antikushtetues.

3. Ligji për kthimin e pronave ka të bëjë vetëm me pasuritë e paluajtshme, por gjykata padrejtësisht, e ka zbatuar edhe për huatë e marra para çlirimit, duke shkelur të drejtat tona.

4. Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në ligj, kur në të ngrihen disa probleme ligjore, të cilave duhej t'u jepej përgjigje me vendim të arsyetuar.

5. Nga arsyetimet e vendimeve të gjykatave del se ato nuk janë nisur nga ligji dhe për zbatim të tij, por nga motive politike, duke zëvëndësuar legjislativin. Lënia në fuqi e këtyre vendimeve nxit kërkesat për huatë e paraçlirimit dhe krijon problem social në shkallë republike.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Durrës, i cili është lënë në fuqi nga shkallët e tjera të gjykimit, janë detyruar kërkuesit me cilësinë e të padituve që të paguajnë shumën 3.236.071 lekë në favor të personit të interesuar, Krisanthi Qirko. Kjo shumë përfaqëson 475 napolona ari të marra hua nga trashëgimlënësi i kërkuesve në vitin 1938.

Duke iu referuar nenit 1 të ligjit nr.355, datë 21.11.1946 "Mbi shlyerjen e huave që kanë lindur para 29 nëntorit 1944", ku thuhet: "Të gjitha huatë që kanë lindur përpara datës 29 nëntor 1944 shlyhen krejt", kërkuesit pretendojnë që ky detyrim është shuar. Në kundërshtim me këtë pretendim, gjykatat arsyetojnë se me shfuqizimin e Kushtetutës së vitit 1976 dhe hyrjen në fuqi të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese është shfuqizuar çdo dispozitë që ka dalë përpara ose që vjen në kundërshtim me frymën e këtij ligji. Kështu, në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, arsyetohet se "me shfuqizimin e Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të miratuar më 28.12.1976 dhe hyrjes në fuqi të ligjit mbi dispozitat kryesore kushtetuese nr.7491, datë 24.4.1991 dhe shtojcat e mëvonshme dhe, në mënyrë të veçantë të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", shfuqizohet çdo dispozitë ligjore e nënligjore, apo vendim gjykate i dalë pas datës 29 nëntor 1944…".

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, duke pranuar në vendim se ligji nr.355, datë 21.11.1946 "ka patur karakter të theksuar politik që nëpërkëmbte të drejtat themelore të njeriut, pasi hynte në marrëdhëniet thjeshtë midis shtetasve", vazhdon me këtë arsyetim: "Me miratimin e ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 "Për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut" dhe ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", është shfuqizuar çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me frymën e këtyre ligjeve (për rrjedhojë dhe ligji nr.355, i vitit 1946) dhe të dy palët do të fitojnë të njëjtat të drejta e detyrime që ato kanë patur karshi njëri-tjetrit".

Gjykata Kushtetuese çmon se vendimet e gjykatave janë antikushtetuese, për faktin se është vepruar në kundërshtim me dispozitat konkrete kushtetuese duke tejkaluar kompetencat e tyre.

Në nenin 8/2 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", që ka qenë në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes, përcaktohet se kur gjatë shqyrtimit të çështjes gjykata arrin në përfundimin se akti normativ nuk pajtohet me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe me ligjet, ajo pezullon gjykimin dhe ia dërgon materialet e çështjes Gjykatës Kushtetuese. Për rëndësinë që ka kjo normë kushtetuese, e cila përcakton qartë kufirin e kompetencave, është sanksionuar edhe në nenin 145 të Kushtetutës. Në fakt, duke u shprehur për papajtueshmërinë me dispozitat kryesore kushtetuese të ligjit nr.355, datë 21.11.1946, gjykatat kanë tejkaluar kompetencat e tyre, duke ndërhyrë në kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, prandaj vendimet e tyre janë antikushtetuese dhe procesi gjyqësor i parregullt.

Nga ana tjetër, arsyetimi se me hyrjen në fuqi të dispozitave kryesore kushtetuese dhe ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave shfuqizohet çdo dispozitë ligjore e nënligjore apo vendim gjykate i dalë pas datës 29 nëntor 1944 ose çdo dispozitë ligjore që vjen në kundërshtim me frymën e këtyre ligjeve, është krejtësisht i gabuar dhe antikushtetues. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" është shfuqizuar vetëm Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e miratuar më 28.12.1976, si dhe ndryshimet e mëvonshme të saj. Ky qëndrim është mbajtur edhe në Kushtetutë, ku sipas nenit 182 të saj shfuqizohet ligji nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si dhe ligjet e tjera kushtetuese, por kurrësesi të gjitha dispozitat ligjore dhe në asnjë mënyrë vendimet e gjykatave. Për më tepër, në nenin 178/1 të Kushtetutës është sanksionuar parimi i rëndësishëm se ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara

para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës, do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar. Në interpetimin që i ka bërë kësaj dispozite Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.77, datë 31.12.1998, arsyeton se ky rregull do të zbatohet edhe për ato ligje apo akte normative që në tërësi apo pjesë të veçanta vijnë në kundërshtim me dispozita konkrete të Kushtetutës. Në këtë kuptim, arsyetimi i Kolegjit Civil se shfuqizohet çdo dispozitë ligjore që vjen në kundërshtim me frymën e këtyre ligjeve, është antikushtetues jo vetëm për shkak të tejkalimit të kompetencës, siç u përmend më lart, por edhe të qëndrimit në kundërshtim me sa parashikon dispozita kushtetuese.

Këto probleme ligjore kërkuesit i kanë ngritur edhe në rekursin drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por Kolegji Seleksionues i kësaj Gjykate, padrejtësisht, ka vendosur mospranimin e rekursit, sepse nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenet 472 e 473 të Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë, edhe vendimi i Kolegjit Seleksionues duhet të shfuqizohet si antikushtetues.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese duke iu rikthyer edhe një herë analizës që përbën thelbin e çështjes lidhur me qëndrimin e gjykatave ndaj ligjit nr.355, datë 21.11.1946, thekson se ky qëndrim është antikushtetues, sepse gjykata nuk ka të drejtë të mos e zbatojë një ligj që sipas saj ka karakter të theksuar politik. Në rast se gjykata çmon se ligji nuk pajtohet me Kushtetutën, ajo është e detyruar të pezullojë gjykimin dhe t'ia dërgojë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Çdo qëndrim tjetër e bën procesin gjyqësor të parregullt.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 e 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr.3186, datë 24.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Durrës; nr.1631, datë 22.3.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.1422, datë 08.10.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.N-18, datë 18.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.99, datë 31.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Gjergj Sauli,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Kujtim Puto,	Anëtar i ""
Tefta Zaka,	Anëtare e ""
Sokol Sadushi,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço,	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 30.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.100 Akti që i përket:

KËRKUESE: AVNI SHEHU, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.18
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. LUAN RAMA, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.18, përfaqësuar nga avokat Mirash Martini.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.18, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.196, datë 24.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Avni Shehu ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese ku pretendon se vendimi nr.196, datë 24.7.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.18, është i pambështetur në ligj e në prova e si i tillë duhet të shfuqizohet e për pasojë zgjedhjet në këtë zonë të shpallen të pavlefshme.

Nga shqyrtimi i materialeve të çështjes ka rezultuar e provuar se kërkuesi nuk rezulton të ketë bërë ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj vendimit nr.3, datë 22.7.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.18, që shpalli rezultatet e zgjedhjeve si dhe kandidatin fitues zotin Luan Rama. Në këtë mënyrë, kërkuesi është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese pa konsumuar mjetet e tjera ligjore të ankimit në rrugën administrative e për pasojë, në kuptim të nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës dhe neneve 107 e 140 të Kodit Zgjedhor nuk legjitimohet të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

Lidhur me këtë shkak, në kërkesën e tij kërkuesi pretendon se Kodi Zgjedhor, e sidomos neni 113 pika 5 dhe neni 141 pika 1 nuk e lidhin ankimin në Gjykatën Kushtetuese me ankimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Po sipas kërkuesit, në mbështetje të nenit 42 pika 2 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese duhet të ndërhyjë për të mbrojtur të drejtat kushtetuese për zgjedhje të lira e të barabarta.

Duke shqyrtuar këto pretendime, Gjykata shprehet se është pikërisht detyrimi kushtetues i parashikuar në nenin 131 shkronja "e" që e obligon Gjykatën Kushtetuese të merret me shqyrtimin e konflikteve në fushën elektorale. Por, kjo veprimtari e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të konceptohet jashtë rregullave të tjera të përcaktuara nga Kushtetuta e nga Kodi Zgjedhor. Kështu, sipas Kushtetutës e pikërisht nenit 131 shkronja "f", kërkesën për një proces të rregullt ligjor Gjykata Kushtetuese mund ta shqyrtojë pasi individit t'i jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e tyre. Në rastin konkret, nuk rezulton që kërkuesi të ketë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike e konkretisht ankimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj vendimit të Komisionit të Zonës Zgjedhore, bazuar në nenet 140 pika 2 dhe 141 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Kërkuesi në kërkesën e tij ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese të shprehet për të gjitha shkeljet që ai ka parashtruar për zgjedhjet e datës 24 qershor, për ato të datës 8.7.2001 si dhe për raundin e dytë të zgjedhjeve të datës 22.7.2001.

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese konkludon se kërkuesi në mbarim të çdo faze zgjedhje, me nxjerrjen nga ana e Komisionit të Zonës Zgjedhore dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vendimeve përkatëse ka pasur të drejtë që në atë kohë t'i godasë ato për pavlefshmëri në kuptim të nenit 131 të Kodit Zgjedhor. Me kalimin e afateve ligjore e drejta për t'u ankuar është parashkruar për fazat e kaluara, duke mbetur efektive e drejta e ankimit vetëm për aktyet e mara gjatë e pas raundit të dytë, atë të datës 08.07.2001.

Megjithatë, ashtu siç u theksua më sipër edhe kjo kërkesë duhet të rrëzohet për mungesë

legjitimimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenet 131 shkronja "e, f" të Kushtetutës, neneve 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 140 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.106, datë 1.8.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Alfred Karamuço,	Anëtar i	""
Kujtim Puto,	Anëtar i	""
Kristofor Peçi,	Anëtar i	""
Sokol Sadushi,	Anëtar i	""
Petrit Plloçi,	Anëtar i	""
Zija Vuci,	Anëtar i	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 29.5.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.45 Akti që i përket:

KËRKUES: QEMAL, MUTAFA E MUHEDIN TOPULLI, përfaqësuar nga avokatët Abaz Brati e Liljana Korvafa, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: VILSON E ZEQINE TOPULLI

O B J E K T I:

Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.1175, datë 20.10.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.1342, datë 2.11.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (Baza Ligjore: nenet 131/f, 134/2 dhe 42/1 të Kushtetutës)

Çështja objekt shqyrtimi, me të njëjtat palë, me të njëjtin shkak dhe me të njëjtin objekt, është gjykuar dhe zgjidhur me vendimin nr.1077, datë 18.10.1946 të Gjykatës së Prefekturës së Tiranës, me të cilin është rrëzuar padia e trashëgimlënësit të subjekteve të interesuar, Eqerem Topullit, për shkak të heqjes dorë nga ana e tij nga e drejta e padisë. Ky vendim, pasi ka marrë formën e prerë është regjistruar në hipotekë në emër të kërkuesve.

Megjithatë, Gjykata e Rrethit Tiranë e ka marrë në shqyrtim përsëri të njëjtën padi dhe ka vendosur pranimin e saj. Ky vendim i gjykatës së rrethit është lënë në fuqi edhe nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë.

Kjo zgjidhje, e cila i kundërvihet parimit të gjësë së gjykuar, përbën proces të parregullt ligjor.

Veç sa sipër, konkluzionet e Kolegjeve të Bashkuara janë të gabuara edhe për shkak se barazojnë një vendim gjyqësor të formës së prerë siç është vendimi i Gjykatës së Prefekturës së Tiranës me kontratat e vlesuara.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesit e kërkuesve, subjektin e interesuar dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1342, datë 02.11.2000, kanë lënë në fuqi vendimin nr.1175, datë 20.10.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka prishur vendimin nr.363, datë 6.2.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka lënë në fuqi vendimin nr.4926, datë 29.9.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Në këtë mënyrë, krahas kërkuesve Muhedin, Qemal, Mustafa e Agim Topulli, edhe subjektet e interesuar Vilson e Zeqine Topulli janë njohur bashkëpronarë në pasurinë objekt konflikti, të përbërë nga një godinë trekatëshe dhe në një truall nën të e përreth saj me sipërfaqe 1817.4 m2, të ndodhura këto në lagjen "Ali Demi", nr.74, Tiranë.

Kërkuesit kanë pretenduar se gjykimi i kësaj çështje është realizuar pa kaluar nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, në kundërshtim me kërkesat e nenit 42/1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Sipas tyre, kjo shkelje kushtetuese ka të bëjë me mosrespektimin nga ana e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë të parimit procedural "të gjësës së gjykuar". Ky është i vetmi shkak që ata kanë parashtruar përpara Gjykatës Kushtetuese dhe që e kanë ngritur në formë prapësimi në të gjitha shkallët e gjykimit të zakonshëm.

Ata kanë thënë se padia e subjekteve të interesuar është po ajo që ka ngritur trashëgimlënësi i tyre Eqerem Topulli në vitin 1946 në Gjykatën e Prefekturës Tiranë, pasi edhe ky gjyq është zhvilluar midis të njëjtave palë, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak dhe se kjo gjykatë me vendimin nr.1077, datë 18.10.1946 ka vendosur rrëzimin e kësaj padie për shkak se në atë kohë i lartpërmenduri ka hequr dorë nga e drejta e padisë.

Subjektet e interesuar, Vilson e Zeqine Topulli, në përgjigje të këtij prapësimi, kanë pretenduar se kjo heqje dorë nga padia është bërë me marrëveshje të palëve, me qëllim që ata t'i shmangeshin shpronësimeve për efekt të tatimit të jashtëzakonshëm, se vendimi i lartpërmendur i Gjykatës së Prefekturës nuk ka ushtruar asnjë ndikim në marrëdhëniet e tyre të bashkëpronësisë se edhe pas këtij vendimi kërkuesit e kanë njohur Eqeremin "de facto" si bashkëpronar, si mbi shtëpinë ashtu edhe mbi truallin, se këto prona ata i kanë administruar bashkërisht deri në vitin 1950, kohë në të cilën doli dekreti nr.801 mbi shtetëzimin e tyre. Ata kanë thënë se katër vëllezërit Eqeremi, Muhedini, Shehapi e Qemali, kundrejt këtij shtetëzimi kanë marrë në bashkëpronësi si kompensim nga shteti banesa të tjera; se njërën prej tyre e kanë vënë në shitje dhe kundërvleftën e realizuar e kanë ndarë në pjesë të barabarta, kurse të tjerat më vonë i kanë pjestuar në natyrë, në mënyrë vullnetare.

Në këto kushte, kur palët kanë mbajtur qëndrime të ndryshme dhe subjektet e interesuara i kanë bazuar kërkimet e tyre në shkaqe që nuk janë të njëjta me ato që ka parashtruar në padinë e tij trashëgimlënësi i tyre Eqerem Topulli, gjykatat që kanë gjykuar çështjen, me të drejtë e kanë bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor faktin e ekzistencës ose jo të situatës juridike, që ka lidhje me problemin e "gjësë së gjykuar".

Po ashtu, për sqarimin e kësaj rrethane, ata me të drejtë kanë proceduar edhe në marrjen e provave, duke i kërkuar secilës palë paraqitjen e tyre. Mbi këtë bazë dhe brenda prerogativave të veta, ato kanë bërë vlerësimin e këtyre provave dhe kanë vendosur për çështjen.

Prandaj, Gjykata Kushtetuese e quan të nevojshme të ripohojë qëndrimin e saj tashmë të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave është atribut vetëm i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues.

Sfera e kompetencave të kësaj Gjykate për shqyrtimin e ankesave të individëve është e kufizuar. Në vështrim të nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës ajo gjykon çështje të kësaj natyre, por kurdoherë kërkohet që shkelja e së drejtës kushtetuese të jetë e lidhur detyrimisht me një proces të parregullt ligjor, ku nuk përfshihet as mënyra e zbatimit të ligjit material, as mënyra e vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja "f" të

Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin si të pabazuar të kërkesës së Muhedin, Qemal, Mustafa dhe Agim Topullit për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.1175, datë 20.10.1998 të Gjykatës së Kasacionit, si dhe vendimit nr.1342, datë 2.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 3.8.2001
Doli nga shtypi më 6.8.2001

Tirazhi: 4100 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "At Gjergj Fishta" sh.p.k.
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë